MANUAL[1]

I INSPEKTIMIT TË PRONËSISË INTELEKTUALE

"PËR INSPEKTORATIN SHTETËROR TË MBIKËQYRJES SË TREGUT"

Shkurt 2023

[1] Në vijim "Manuali".

Tabela përmbledhëse

Falenderime 5
Hyrje 6
Qëllimi i Manualit 8
Objektivat kryesore të manualit 9

Kapitulli I: Të përgjithshme 10
Qëllimi i inspektimit në fushën e pronësisë intelektuale 10
Baza ligjore 10
Përkufizime dhe shkurtime/akronime 11
Parimet 13
Llojet e inspektimit 14

Kapitulli II: Veprimtaria e inspektorit/grupit të inspektimit 16
Roli i inspektorit/grupit të inspektimit 16
Përgjegjësitë e inspektorëve/ grupit të inspektimit 16
Mënyra e plotësimit të dokumentacionit (procesverbal, listë verifikimi) 18

Kapitulli III: Unifikimi i procedurave të inspektimit për monitorimin e të drejtave të pronësisë industriale 20
Inicimi i procedurës së inspektimit 20
Inspektimi me ankesë-kërkesë 20
Hapi I: Administrimi i ankesë-kërkesës 21
Hapi II: Verifikimi paraprak 21
Subjektet që legjitimohen për paraqitjen e kërkesë-ankesës 22
Objekti i kërkesë-ankesë për inspektim 22
Përmbajtja e kërkesë-ankesës 22
Dokumentacion shoqërues 23
Hapi III: Trajtimi i kërkesë-ankesës dhe verifikimi i dokumentacionit shoqërues 23
Trajtimi i kërkese-ankesës 23
Verifikimi i dokumentacionit shoqërues 24
Shqyrtimi dhe verifikimi i kërkesë-ankesës 25
Hapi IV: Nxjerrja e autorizimit të inspektimit 25
Hapi V: Njoftimi paraprak i autorizimit 26
Hapi VI: Hetimi administrativ (Inspektimi) 27
Hapi VII: Vijimi i procedurave administrative 33
Hapi VIII: Vendimmarrja e ISHMT-së 34
Hapi IX: Njoftimi i vendimit të marrë nga ISHMT-ja 35
Hapi X: Arkivimi i procedurës së inspektimit 35

Inspektimi ex-officio/ kryesisht 36
Hapi I: Nxjerrja e autorizimit të inspektimit 36
Hapi II: Njoftimi paraprak i autorizimit 36
Hapi III: Procedura e Inspektimit 37
Hapi IV: Vijimi i procedurave administrative 43
Hapi V: Vendimmarrja e ISHMT-së 45
Hapi VI: Njoftimi i vendimit të marrë nga ISHMT-ja 45
Hapi VII: Arkivimi i procedurës së inspektimit 45
Hapi VIII: Verifikimi i plotësimit të mangësive të lëna subjektit të inspektuar 46

Kapitulli IV: Unifikimi i procedurave të inspektimit për monitorimin e të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to 47
Qëllimi i inspektimit në fushën e të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to 47
Inicimi i procedurës së inpektimit 47
Objekti i kontrollit 48
Procedurat e inspektimit 49
Inspektimi ex officio/kryesisht 49
Hapi I: Nxjerrja e autorizimit të inspektimit 49
Hapi II: Njoftimi paraprak i autorizimit 50
Hapi III: Hetimi administrativ 51
Verifikimi dhe marrja e provave 51
Hapi IV: Vijimi i procedurave administrative 52
Hapi V: Njoftimi i vendimit të ISHMT 53
Hapi VI: Vendimmarrja e ISHMT-së 54
Hapi VII: Njoftimi i vendimit të marrë nga ISHMT-ja 54
Hapi VIII: Arkivimi i procedurës së inspektimit 55
Hapi IX: Verifikimi i plotësimit të mangësive të lëna subjektit 55

Kapitulli V: Parime të përgjithshme të etikës 56
Legjislacioni zbatues 56
Parimet e etikës 56
Shmangia dhe deklarimi i konfliktit të interesit 57
Ushtrimi i veprimtarive të jashtme të inspektorëve 57
Integriteti profesional i inspektorëve 57
Konfidencialiteti dhe ruajtja e informacionit 58
Zbatimi i rregullave të etikës 58
Përgjegjësitë e inspektorit 58
Detyrimi për njoftim 59

Kapitulli VI: Çështje praktike 60

Paraqitja grafike e procesit të inspektimit 64

Falenderime!

Ky manual është hartuar me mbështetjen e fondacionit zviceran "Swisscontact", por një falenderim i veçantë i takon ekspertëve të ISHMT-së, të cilët me profesionalizmin, gadishmërinë dhe bashkëpunimin e pamunguar, kanë kontribuar në dhënien e opinioneve/rekomandimeve, në funksion të hartimit të një dokumenti, i cili do t'i sigurojë mbështetje ISHMT-së, në garantimin dhe mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale.

Hyrje

Anëtarësimi në Bashkimin Evropian është prioritet i Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe hapja e negociatave në kuadër të anëtarësimit në BE, parashtron para vendit një sërë detyrimesh dhe angazhimesh, ku një ndër fushat që ka një impakt, si në tregun e brendshëm, ashtu edhe atë të jashtëm është fusha e pronësisë intelektuale. Pronësia intelektuale është një fushë shumë e gjerë dhe përfshin institucione që i takojnë sektorëve të ndryshëm, dhe në këtë kuadër një rol të rëndësishëm ka edhe procesi i mbikëqyrjes dhe mbrojtjes së të drejtave që derivojnë në këtë fushë. Vlen të theksohet fakti se, në këtë sferë janë ndërmarrë një sërë iniciativash, të cilat fillimisht janë pasqyruar në kuadrin rregullator, duke bërë edhe përafrimin me Acquis Communitare.

Ndër nismat me impakt të thellë në fushën e pronësisë intelektuale, ka qënë miratimi i strategjive afatmesme, si dhe amendimi dhe plotësimi i legjislacionit të posaçëm. Në këtë kuadër, vlen të theksojmë që së fundmi me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 350, datë 26.5.2022, "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Pronësinë Intelektuale, 2022–2025" u konkretizua dokumenti më i rëndësishëm strategjik në fushën e pronësisë intelektuale, i cili ka ardhur si një bashkëpunim i institucioneve përgjegjëse për zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale në Republikën e Shqipërisë, si: DPPI, ISHMT, DPD, etj. Strategjia Kombëtare e Pronësisë Intelektuale, 2022–2025, shpreh vizionin e Qeverisë Shqiptare drejt një sistemi më të fortë të pronësisë intelektuale në Republikën e Shqipërisë, e cila siguron mbrojtje efektive të të drejtave të pronësisë intelektuale, inkurajon krijimtarinë dhe inovacionin në shërbim të rritjes ekonomike dhe zhvillimit kulturor dhe shkencor në Republikën e Shqipërisë .

Një rëndësi të veçantë paraqet implementimi i Strategjisë 2022–2025, e cila përbën një element thelbësor në progresin e mëtejshëm social ekonomik, në rritjen e konkurrencës së ndershme, krijimin e besueshmërisë në treg, dhe integrimin evropian. Pjesë përbërëse e kësaj Strategjie janë sigurimi i të drejtave të pronësisë intelektuale, mirëfunksionimi i sistemit gjyqësor, si dhe modernizimi i institucioneve të përfshira në sistem.

Niveli i mbrojtjes së të drejtave të pronësisë intelektuale duhet të jetë i njëjtë me atë të Bashkimit Evropian, dhe për rrjedhojë Strategjia dhe kuadri ligjor dhe nënligjor, gjithashtu kërkon një koordinim më të mirë në zbatimin efektiv të pronësisë intelektuale midis institucioneve kompetente dhe aktorëve të tjerë. Në këtë kontekst, ligji nr. 9947, datë 07/07/2008, "Për pronësinë industriale" ndryshuar me ligjin nr.10/2013, datë 14.02.2013, dhe ligjin nr. 55/ 2014 datë 29/05/2014, dhe ligjin nr. 96/2021, solli përmirësime për sa i përket përafrimit me direktivat e BE, ngritjes dhe përcaktimit të përgjegjësisësë Inspektoratit

të Mbikëqyrjes së Tregut, duke autorizuar dhe ngarkuar e Inspektoratin Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut, për mbikëqyrjen dhe mbrojtjen e pronarit ose mbajtësit e të drejtave të një patente, disenjoje ose marke të regjistruar ose përdoruesit e autorizuar të treguesit gjeografik të regjistruar për mallrat e importuara në Republikën e Shqipërisë ose për mallrat e tjera brenda tregut, të cilat cënojnë të drejtat e tyre[2].

Gjithashtu, një rol të rëndësishëm ka edhe garantimi dhe mbrojtja e të drejtave të autorit, e cila gjen aplikim në të gjitha veprat origjinale letrare, shkencore dhe artistike, ku përfshihen: librat, muzika, skulpturat, pikturat, fotografitë, filmat, programet radio-televizive, programet kompjuterike. E drejta e autorit përfshihet dhe te subjekte të tjera, e cila përfshin regjistrimin e tingujve (të tilla si: regjistrimet, kasetat dhe kompakt disqet) performancat e interpretuesve dhe sinjalet e komunikimit. E drejta e autorit dhe te drejtat të lidhura me to, janë thelbësore për krijimtarinë njerëzore, duke u dhënë në këtë mënyrë nxitje krijuesve në formën e njohjes dhe shpërblimeve të drejta ekonomike. Sipas këtij sistemi të drejtash krijuesit janë të siguruar që veprat e tyre mund të shpërndahen pa frikën e kopjimit të paautorizuar dhe piraterisë. Kjo është për të ndihmuar rritjen e aksesit dhe për të shijuar kënaqësinë e kulturës, njohurive dhe argëtimeve në të gjithë botën.

Në terma konkrete, mbrojtja e të drejtave të autorit siguron garantimin e tyre, në aspektin ekonomik dhe atë moral.

Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut (këtu e në vijim referuar “ISHMT”) është krijuar me VKM nr. 36 , datë 20.01.2016, “Për krijimin , organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut”. ISHMT, është institucion në varësi të ministrit përgjegjës për tregtinë. Në fushën e tij të përgjegjësisë ky institucion është përgjegjës për inspektimin në fushën e sigurisë së produkteve jo ushqimore për përdorim nga konsumatorët dhe fushën e pronësisë intelektuale.

Regjistrimi i të drejtave të pronësisë industriale dhe mbrojtja e tyre janë reflektuar në një sërë aktesh rregullatorë, por është konstatuar problematike pjesa e zbatimit të të drejtave të pronësisë industriale për mallrat e falsifikuara, mallrat pirate ose mallrat që dyshohet se shkelin një të drejtë të pronësisë industriale në tregun vendas. Në këtë kontekst, pas kontatimeve mbi rëndësinë dhe kërkesat për përmirësimin dhe rritjen e eficiencës dhe efektivitet të inspektimeve, kryesisht në fushën e pronësisë industriale janë propozuar amendimet ligjore të ligjit nr. 9947/2008, propozime, të cilat janë adresuar edhe si një instrument rregullator në kuadër të mangësive ligjore të evidentuara në terren nga trupat inspektuese dhe përshtatjen me dinamikën e tregut të brendshëm.

Në këtë kuadër, ligji nr. 96/2021, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligj nr.9947, datë 7.7.2008, “Për pronësinë industriale”, të ndryshuar, amendoi ndër të tjera dispozitat që lidhen me:

[2] Neni 188, i ligjit nr. 9947/2008.

- Funksionimin e ISHMT-së dhe rolin e saj në fushën e pronësisë industriale;
- Procedurat për mbrojtjen administrative të shkeljes së të drejtave të pronësisë industriale;
- Përparësitë që vijnë janë sigurimi i një standardi procedural për sigurimin e respektimit të të drejtave të pronësisë industriale;
- Ndërveprimin institucional ndërmjet institucioneve shtetërore të përfshira në fushën e pronësisë industriale.

Ndryshimet ligjore në lidhje me procedurat e mbikëqyrjes së tregut për inspektimet, koordinimin ndërinstitucional dhe rolin e ISHMT, solli nevojën e hartimit të një dokumenti, që do të shërbejë për dokumentimin e praktikave më të mira për procedurat dhe proceset e standardizuara për ISHMT, në përputhje me kërkesat ligjore. Në këtë kuadër, me mbështetjen e fondacionit zviceran "***Swisscontact***", mundësohet hartimi i "Manualit", ku parashikohet çdo hap procedural që qartëson rolin e Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut, në fushën e pronësisë intelektuale, rregullon dhe unifikon procesin e inspektimit në fushën e të drejtave të pronësisë industriale dhe të të drejtave të autorit, jep udhëzime mbi trajtimin e rasteve specifike dhe problematikave të hasura gjatë zbatimit të legjislacioneve të posaçme në kuadër të inspektimit. Gjithashtu, "Manuali" sanksionon edhe njëherë parimet themelore, të cilat garantojnë paanshmëri, barazi, dhe garantim të të drejtave të subjekteve mbajtës të të drejtave të pronësisë industriale dhe ato intelektuale, dhe subjekteve që ju nënshtrohen procedurave të inspektimit.

Qëllimi i Manualit

Qëllimi i këtij "Manuali" është ofrimi i një instrumenti në funksion të përmbushjes së kompetencave ligjore dhe parandalimin e ndërhyrjeve arbitrare të inspektorëve në subjektet, personat fizikë, personat juridikë apo subjekte të tjera, që funksionojnë dhe operojnë, sipas legjislacioneve përkatëse në fuqi. Gjithashtu, nëpërmjet krijimit të këtij dokumenti, synohet të garantohet përputhshmëria e veprimeve të ISHMT-së me legjislacionin në fuqi dhe të adresohet përmbushja e kërkesave ligjore për vlerësimin e ligjshmërisë në tregun e pronësisë intelektuale nga ana e inspektorëve përgjegjës.

Sigurimi i një standardi procedural për respektimin e të drejtave të pronësisë intelektuale, duke qartësuar çdo hap procedural, qartëson dhe rolin e Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut, në fushën e pronësisë industriale dhe atë të të drejtëve të autorit, dhe të drejtat e lidhura me to, detyrat, si dhe përfshirjen aktive të operatorëve ekonomikë, në procesin e inspektimit. Ky "Manual", gjithashtu ka si qëllim monitorimin dhe garantimine respektimit të të drejtave të pronësisë industriale nëpërmjet hartimit të një udhëzimi praktik për vendosjen e një procedure standarde të unifikuar për monitorimin e të drejtave të pronësisë industriale. Përcaktimi në mënyrë të detajuar i procesit të inspektimit nga ana e ISHMT-së, mbi respektimin e të drejtave të pronësisë industriale kur ekzistojnë shkaqe të arsyeshme dyshimi se një e drejtë e pronësisë industriale është shkelur për mallrat,të

cilat janë vendosur në treg dhe janë në shërbim/përdorim në territorin e Republikës së Shqipërisë, pas çlirimit në qarkullim të lirë nga autoritetet doganore.

Inspektimi do të mund të arrijë efektivitet maksimal nëse kryhet në kushtet e një bashkëpunimi reciprok dhe me përgjegjshmëri me subjektet e inspektimit. Një metodë e tillë siguron arritjen e rezultateve më të mira të përbashkëta, dhe kjo për arsye se askush tjetër nuk ka njohje më të thellë dhe më të mirë të veprimtarisë së subjekteve të inspektimit. Përfshirja dhe bashkëpunimi ndërmjet inspektorateve shtetërore dhe subjekteve të inspektimit është thelbësore në çdo fazë të veprimtarisë inspektuese. Ky manual synon të japë aktivitete kryesore të përbashkëta për të arritur një rezultat sa më cilësor në veprimtarinë e inspektimit, me qëllim që ky proces:

- Të jetë i bazuar në kuadrin ligjor dhe/nënligjor në fuqi;
- Të mbështetët në parimin e barazisë, garantimit të të drejtave të subjekteve ndaj veprimeve të inspektorëve, si e drejta për t'u infomuar, njohur me aktet e autorizimit, objektin e inspektimit, etj;
- Të jetë transparent dhe të minimizohet/ shmangen kontestimet e vendimmarrjes së inspektorëve, si aspektin procedural dhe atë material.

Në zbatim të dhe respektim të hierarkisë së normave juridike sanksionuar në nenin 116, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, manuali nuk synon plotësimin e vakumeve ligjore apo interpretimin e dispozitave ligjore dhe nënligjore, të cilat zbatohen në fushën e inspektimeve dhe pronësisë intelektuale.

Objektivat kryesore të manualit

Objektivi kryesor: Garantimi i unifikimit të praktikave të inspektimit, në kuadër të mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave të pronësisë industriale dhe të të drejtave të autorit dhe të drejtat e lidhura me to.

Objektivi 1: Zbatimi i kërkesave ligjore nga inspektorët, konform legjislacionit në fuqi të drejtave të pronësisë intelektuale.

Objektivi 2: Unifikimi i procedurave të inspektimit, sipas parashikimeve ligjore të ligjit kuadër për inspektimin dhe legjislacionit të posaçëm të fushës së pronësisë industriale të të të drejtave të autorit dhe të drejtëva të tjera të lidhura me to.

KAPITULLI I

Të përgjithshme

1. Qëllimi i inspektimit në fushën e pronësisë intelektuale

ISHMT, ushtron veprimtarinë inspektuese për vlerësimin e përputhshmërisë së veprimtarisë së subjekteve me përcaktimet e parashikuara nëligjin nr. 9947, datë 07/07/2008, "Për pronësinë industriale" ndryshuar dhe ligjin nr. 35/2016, "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to".

ISHMT, është përgjegjës për të monitoruar e garantuar respektimin e të drejtave të pronësisë industriale kur ekzistojnë shkaqe të arsyeshme dyshimi se një e drejtë e pronësisë industriale është shkelur nga mallrat, të cilat janë vendosur në treg dhe janë në shërbim/ përdorim në territorin e Republikës së Shqipërisë, pas çlirimit në qarkullim të lirë nga autoritetet doganore, si dhe kontrollin në tregun e brendshëm, të produkteve fizike dhe/ ose lejes së lëshuar nga mbajtësit e të drejtave të autorit, sipas parashikimeve ligjore në fuqi. Gjithashtu, ISHMT, monitoron dhe garanton të drejtat e krijuesve origjinale të veprave të mbrojtura me të drejtën e autorit, dhe trashëgimtarëve të tyre.

2. Baza ligjore

ISHMT, ushtron veprimtarinë në fushën e pronësisë intelektuale, bazuar, por pa u kufizuar, në:

- ✓ Ligjin horizontal nr. 10433, datë 16.06.2011, "Për ispektimin në Republikën e Shqipërisë", i cili përcakton parimet e përgjithshme të inspektimit, organizimin e inspektorateve shtetërore, që kryejnë funksione inspektimi, statusin e inspektorëve, rregullat e procedimit administrativ të inspektimit.
- ✓ Ligjin nr. 9947/2008, "Për pronësinë industriale", të ndryshuar, sipas të cilit, ISHMT-ja është përgjegjëse për inspektimin e zbatimit të kërkesave të detyrueshme ligjore në fushën e pronësisë industriale;
- ✓ Ligjin nr. 35/2016, "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to", sipas të cilit ISHTM, garanton mbrojtjen dhe të respektimin e të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to;
- ✓ Gjithashtu, për sa nuk përcaktohet në kuadrin ligjor të sipër cituar, ISHMT zbaton dispozitat përkatëse të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë";
- ✓ VKM nr. 36, datë 20.01.2016, "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e

Inspektoratit Shtetëror të Mbikqyrjes së Tregut";

- ✓ Udhëzimin e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes Nr. 177, "Për metodat e klasifikimit të risqeve dhe vlerësimit të riskut serioz", datë 26/12/2013;
- ✓ Urdhrin e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes Nr. 305, "Për procedurat standarte operacionale të veprimtarisë së mbikëqyrjes së tregut, të detyrueshme për të gjitha strukturat e mbikëqyrjes së tregut", datë 30/05/2014;
- ✓ Urdhrin e Ministrit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr. 92, "Për miratimin e Rregullores së Brendshme të Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut", datë 16.04.2020;
- ✓ Kodin e Etikës së Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut.

3. Përkufizime dhe shkurtime/akronime

3.1 Përkufizime

a) *Disenjo industriale*", nënkupton karakteristikat e formës së jashtme të një produkti, aspekti ornamental ose estetik i një produkti, si një i tërë ose i pjesëvë të tij, që i jep një pamje të veçantë produktit[3].

b) "*Markë tregtare*",është një shenjë ose kombinim shenjash të cilat paraqiten grafikisht dhe të cilat shërbejnë për të dalluar mallrat ose shërbimet e një personi fizik ose juridik nga ato të një personi tjetër fizik ose juridik[4].

c) "*Mallra pirate*", janë mallra të cilat janë objekt veprimi që shkel të drejtat e një disenjoje industriale në Republikën e Shqipërisë dhe janë/ose përmbajnë kopje të bëra pa pëlqimin e mbajtësit të të drejtave të lidhura me disenjon industrial apo të një personi të autorizuar prej mbajtësit në vendin e prodhimit.

d) "*Patenta*" është një e drejtë ekskluzive e dhënë për një shpikje, e cila mund të jetë një produkt ose një proces që siguron një zgjidhje të re teknike për një problem. Patentat lëshohen për shpikje të cilat përbëjnë risi, përmbajnë hap shpikës dhe të cilat janë të zbatueshme në industri, përfshirë dhe bujqësinë[5].

e) *"Një tregues gjeografik"* është një shenjë e përdorur për produktet që kanë një origjinë

[3] Disenjo industriale mund të gëzojë mbrojtje në aspektin e pronësisë industrial, por dhe pronësisë intelektuale. Regjistrimi i një disenjo është i vlefshëm për 5 vjet, duke filluar nga data e depozitimit të aplikimit për regjistrimin e saj. Afati mund të ripërtërihet për një periudhë shtesë prej pesë vjetësh kundrejt pagesë së tarifës së përcaktuar, deri në një periudhë prej 25 vjetësh nga data e depozitimit të aplikimit për regjistrimin e disenjos.

[4] Për të gëzuar mbrojtje kombëtare marka tregtare duhet të regjistrohet pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale. Në nivel ndërkombëtar mund të paraqitet një aplikim për markën tregtare me zyrën e regjistrimit të markës tregtare të secilit vend në të cilin kërkohet mbrojtje, ose mund të përdoret Sistemi i Madridit. Afati i mbrojtjes së markës tregtare është 10 vjet duke filluar nga data e depozitimit.

[5] Patenta siguron mbrojtje për pronarin e patëntës për një periudhë prej 20 vjetësh nga data e depozitimit të aplikimit për patentë. Patentat farmaceutike dhe produktet e mbrojtura bimore pajisen me çertifikatë të mbrojtjes shtesë për një periudhë deri në 5 vjet të tjera. Patentat e lëshuara kanë vlefshmëri vetëm në vendin në të cilin janë lëshuar por në saj të Marrëveshjes së Bashkëpunimit në fushën e Patentave , shpikësit mund të kryejnë aplikim për patent ndërkombëtare, dhe të zgjedhin nëse do shtrihet mbrojtja e të drejtës së tyre për patentë në të gjithë vendet apo vetëm në një pjesë të tyre.

të caktuar gjeografike dhe që posedojnë cilësi ose reputacion për shkak të asaj origjine. Cilësitë, karakteristikat ose reputacioni i produktit duhet të jenë në thelb për shkak të vendit të origjinës.[6]

f) "*Falsifikim i mallrave*[7] (shkelje e të drejtave të markës tregtare)", nënkuptohet *çdo mall, duke përfshirë edhe paketimin, pa autorizimin e një marke tregtare që është i njëjtë me markën e regjistruar në lidhje me këto mallra ose që nuk mund të dallohet në aspektet e saj thelbësore nga një markë e tillë dhe që në këtë mënyrë shkel të drejtat e pronarit të markës tregtare në fjalë sipas ligjit të vendit të importimit.*

g) "*E drejta e autorit*" është e drejta ekskluzive e kopjimit të një vepre krijuese ose për të lejuar dikë të bëjë diçka te tillë.[8]

h) "*Veprat e prejardhura*", janë krijime intelektuale, që realizohen duke u bazuar në një ose disa vepra që kanë ekzistuar më parë, si përkthimet, përshtatjet, aranzhimet muzikore, ilustrimet, dokumentarët, riprodhimet artistike, faqet e internetit me të dhëna statike ose ndërvepruese, si dhe ndryshime të tjera të krijimeve/veprave letrare, shkencore ose artistike origjinale që mund të transformohen, të rimodelohen ose të përshtaten, dhe të cilat mbrohen si krijime/vepra origjinale në mënyrë të pavarur nga të drejtat e autorit të krijimit origjinal.

i) "*Të drejtat e lidhura*", të tilla si: të drejtat e interpretuesve/ekzekutuesve në lidhje me interpretimet/ekzekutimet e tyre; prodhuesve të regjistrimeve fonografike të tyre; prodhuesve të fiksimeve/(regjistrimeve) të para të filmave të tyre; organizatave transmetuese për transmetimet e tyre; botuesve në lidhje me botimet e tyre; prodhuesve të bazës së të dhënave në lidhje me bazën e të dhënave të tyre.

j) "*Program kompjuterik*" përbën krijimin në çdo formë të një programi kompjuterik, programet e aplikimit dhe sistemet operative të shprehura në çdolloj gjuhe, duke përfshirë materialet përgatitore të projektimit dhe manualet. Idetë dhe parimet që përbëjnë bazën e cilitdo element të një programi 38 kompjuterik, duke përfshirë edhe ato, të cilat përbëjnë bazën e ndërfaqes, nuk do të mbrohen nga e drejta e autorit.

k) *Numri Unik i Identifikimit të Subjektit* (NUIS), është i vlefshëm për identifikimin e subjekteve, për qëllimet e regjistrimit në regjistrin tregtar, për qëllimet e regjistrimit si person i tatueshëm pranë autoriteteve fiskale, qendrore dhe vendore, për skemën e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, për autoritetet e inspektimit të marrëdhënieve të punës, si dhe për çdo qëllim tjetër statistikor ose identifikues[9].

l) "*Mutatis mutandis*", frazë latine, që do të thotë "*në të njëjtën mënyrë*".

[6] E drejta e pronësisë mbi treguesit gjeografikë fitohet me regjistrimin pranë DPPI-së. Pronarët të cilët kanë regjistruar treguesit gjeografikë nuk kanë të drejtë të japin licensa përdorimi. Afati i mbrojtjes së një treguesi gjeografikë është i pakufizuar në kohë dhe përfundon kur nuk ekziston më lidhja ndërmjet vetive të karakteristikave të mallrave dhe mjedisit gjeografikë.

[7] Bazuar në Marrëveshjen, "Për aspekte të të Drejtave të Pronësisë Intelektuale të Lidhura me Tregtinë "Marrëveshja TRIPS".

[8] E drejta e autorit mbi një vepër lind automatikisht në momentin e krijimit të veprës origjinale ose të prejardhur.

[9] Përkufizim sipas ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007, "Për regjistrimin e biznesit", i ndyshuar.

3.2 Shkurtime/akronime

DPD	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
DPPI	Drejoria e Pergjithshme e Poronësisë Industriale
IQ	Inspektorati Qëndror
ISHMT	Inspektorati Shtetërore i Mbikëqyrjes së Tregut
K.P.A.	Kodi i Procedurave Administrative
Manuali	Manuali i Inspektimit të Pronësisë Intelektuale
PI	Pronësisë Intelektuale

4. Parimet

Inspektorët ushtrojnë veprimtarinë e tyre duke u mbështetur në parimet si më poshtë cituar, por pa u kufizuar:

***Parimi i ligjshmërisë*:** Inspektorët ushtrojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe legjislacionin e zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë, brenda kufijve të kompetencave të tyre dhe në përputhje me qëllimin për të cilin janë dhënë këto kompetenca.

***Parimi i drejtësisë dhe paanësisë*:** Në ushtrimin e funksioneve të tij, inspektorati trajton në mënyrë të drejtë dhe të paanshme të gjitha subjektet me të cilat krijon marrëdhënie.

Parimi i transparencës dhe informimit të publikut: Inspektorët duhet të ushtrojnë veprimtarinë administrative në mënyrë transparente dhe në bashkëpunim të ngushtë me personat fizikë dhe juridikë të përfshirë në të. Inspektorati informon subjektet dhe publikun për konstatimet dhe masat e marra gjatë procedimit administrativ të inspektimit, nëse kjo është e nevojshme për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të personave fizikë e juridik.

Parimi i objektivitetit: Gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative të kontrollit dhe monitorimit, inspektorati merr në konsideratë dhe i jep rëndësinë e duhur të gjitha kushteve, të dhënave dhe provave që lidhen me procedurën administrative.

Parimi i pavarësisë: Inspektori apo grupi i inspektimit, është plotësisht i pavarur në kryerjen e procedimit të inspektimit dhe marrjen e vendimeve për një rast konkret.

***Parimi i proporcionalitetit*:** Veprimet e inspektimit kryhen në mënyrë të tillë që ndërhyrja në veprimtarinë e subjektit të inspektimit të jetë vetëm për aq sa është e domosdoshme dhe e përshtatshme për arritjen e qëllimit të inspektimit dhe me mjetet më të përshtatshme të arrihet qëllimi i synuar.

***Parimi i programimit të inspektimit*:** Inspektimi kryhet sipas një programi me tematika të vlerësuara mbi bazën e analizës së riskut.

Parimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale: Veprimet e inspektimit

dhe publikimi i informacionit kryhet në zbatim të kërkesave dhe kushteve të përcaktuara në legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të mbrojtjes së të dhënave që lidhen me sekretin tregtar të sipërmarrësve.

Parimi i zbatimit të dispozitës më të favorshme: Inspektori gjatë punës së tij nëse vëren që një sipërmarrës ka zbatuar një ligj, i cili është në kundërshtim me një tjetër, atëhere ai është i ligjshëm, si dhe në çdo rast zbaton dispozitën më të favorshme në hierarkinë e ligjeve të barazvlefshëm.

5. Llojet e inspektimit

Inspektimet për nga forma e autorizimit dhe organizimit të tyre, ndahen në:

A. *Inspektimi i programuar*: Zhvillohet në përputhje me nenin 24, të ligjit nr. 10 433, datë 16.6.2011, "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë" dhe konsiston kryesisht në këto hapa proceduralë:

- Një inspektim konkret autorizohet, si rregull *në b*azë të programit të inspektimit;
- Programimi i inspektimi hartohet nga vetë inspektorati, bazuar në metodologjitë e vlerësimit të rrezikut dhe në detyrimin për inspektimin periodik në rastet e parashikuara nga ligji i posaçëm;
- Programi i inspektimit të inspektoratit shtetëror miratohet nga ministri përgjegjës pas marrjes së mendimit këshillimor nga Inspektorati Qendror, ndërsa programi i inspektimit të inspektoratit vendor miratohet nga organi ekzekutiv i njësisë së qeverisjes vendore.

Inspektimi i programuar në fushën e Pronësisë Industriale duhet të jetë i bazuar në metodologjinë e riskut, sipas informacioneve të marra nga:

- institucionet e tjera të fushës së PI;
- monitorimet e vetë ISHMT-së në kuadër të ushtrimit të funksioneve ligjore;
- bashkëpunimi me mbajtësit e të drejtave të PI.

Sqarim: *Kontrollet periodike nuk janë të përshtatshme për fushën e zbatimit të të drejatve të PI për shkak të natyës së inspektimit që synon mbrojtjen e të drejtave private të pronarëve të objekteve të PI. Një programim i mirefillte Inpektimesh nuk është i mundur, por një parashikim i bazuar në situatën dhe infirmacionin aktual që eventualisht disponohet nga ISHMT – referuar interpretimit literal dhe sistematik të neneve 24 dhe 25 të Ligjit nr. 10433/2011.*

B. *Inspektimi jashtë programit*: Zhvillohet nga autoriteti inspektues në bazë të nenit 25, të ligjit nr. 10 433, datë 16.6.2011, "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë" por për shkak të natyrës së vecantë dhe marrëdhënieve juridike që mbulon, nëë fushën e PI, forma e vetme e inspektimit jashtë programit është inspektimi mbi bazën e kërkesë-ankesës për inspektim, proces, i cili zhvillohet në përputhje me nenin 200/b, të ligjit nr. 9947/2008, "Për pronësinë industriale".

Sqarim: *Ky inspektim iniciohet me anë të një akt-ankimi drejtuar ISHMT-së nga mbajtësi i së drejtës të pronësisë industriale ose përfaqësuesi i tij me qëllim filimin e procedurave dhe veprimeve përkatëse të inspektimit, kur ekzistojnë shkaqe të arsyeshme dyshimi se shkelet një e drejtë e pronësisë industriale nga mallra dhe/ose shërbime të tjera identike apo të ngjashme, të cilat janë vendosur në treg dhe janë në shërbim/përdorim në territorin e Republikës së Shqipërisë, pas çlirimit në qarkullim të lirë nga autoritetet doganore.*

KAPITULLI II

Veprimtaria e inspektorit/grupit të inspektimit

1. Roli i inspektorit/grupit të inspektimit

1.1 Inspektori/grupi i inspektimit, rol primar ka garantimin dhe mbrojtjen e të drejtave që burojnë nga legjislacioni për pronësinë industriale, dhe/ ose të drejtat që derivojnë nga ligji për të drejtat e autotit dhe të drejtat e lidhura meto.

1.2 Kryen funksionet e inspektimit:
- sipas planit të miratuar dhe autorizimit të nxjerrë;
- në përputhje me metodologjinë dhe standardet e përcaktuara;
- në mënyrën më efiçente për procesin e inspektimit.

1.3 Inspektorët/grupi i inspektimit shtetërorë kyejnë funksionet e tyre në përputhje me legjislacionin e inspektimit dhe ligjet e posaçme të fushës, si dhe në zbatim të rregullave të etikës.

2. Përgjegjësitë e inspektorëve/ grupit të inspektimit

1.1 Inspektorët/grupet të inspektimitduhet kryejnë procesine inspektimit:
- Në mënyrë të pavarur dhe të garantojnëkryerjen e detyrave në përputhje me standardet ligjore dhe profesionale;
- Në mënyrë objektive, duke garantuar njëgjykim të paanshëm dhe të drejtpërdrejtë, duke garantuar zhvillimin e duhur të procesit të inspektimit.

1.2 Kryerja e inspektimit duhet të zhvillohet sipas kuadrit ligjor e rregullator dhe Standardeve të propozuara nga Inspektoratet shtetërore dhe të miratuar nga ministri përkatës dhe Inspektorati Qendror dhe nuk i nënshtrohet asnjë ndikimi tjetër nga individë me autoritet, qofshin këta brenda apo jashtë inspektoratit shtetëror.

1.3 Inspektorët/grupet të inspektimit respektojnë parimet, rregullat e etikës të përcaktuara në aktet e brendshme të institucionit, dhe rregullat e sjelljes gjatë ushtrimit të detyrës.

1.4 Inspektorët respektojnë rregullat e etikës dhe sjelljes në shërbimin civil, si dhe në përputhje me ligjin e inspektimit dhe ligjin e posaçëm të PI-së, si dhe “Kodin e Etikës për punonjësit e Inspektorateve Shtetërore në Republikën e Shqipërisë”.

1.5 Inspektorët/grupet të inspektimit nuk mundtë angazhohen në detyra të tjera brenda inspektoratit shtetëror të cilat nuk lidhen me funksionimin e sistemit të inspektimit dhe janë pjesë e strukturave operacionale të inspektoratit ku ata bëjnë pjesë.

1.6 Inspektorët/grupet të inspektimit, garantojnë shmangien dhe mosndikimin nga çdo

lloj influece, kërcënimi, risku, etj.Një sërë kërcënimesh mund të kompromentojnë pavarësinë e inspektorëve, pavarësisht nëse këto kërcenime janë të pranishëm apo thjesht parashikohen se do të ndodhin. Të tilla kërcënime janë si më poshtë:

Kërcënim i interesit vetjak	Një gjë e tillë ndodh kur inspektorët mund të kenë, ose mendohet se mundtë kenë, ndonjë joshje ekonomike apo të ndonjë formë tjetër që i bën ata të ndryshojnë sjelljen e tyre saqë komprementon pavarësinë ose objektivitetin e gjykimit të tyre (për shembull, bien dakord që të mos përfshijnë objekte apo subjekte të veçanta në programin e punës; ose, mund të jetë shumë pozitiv mbi procesin e inspektimit me qëllim që të sigurojë një reagim të mirë nga subjekti i inspektimit).
Kërcënim i rishikimit të punës vetjake, ose të miqve të tyre	Një gjë e tillë ndodh kur inspektorët janë në një situatë, ose mendohet se janë në një situatë, ku bëjnë rishikimin e punës së tyre ose të kolegëve, të kryer në një subjekt. Një gjë e tillë ndodh kur një inspektor i Inspektoratit shtetëror ka punuar më parë në subjektin që po inspektohet, ose kur inspektorët përfshihen (angazhohen) në veprimtaritë menaxheriale (për shembull, vendosjen e procedurave të inspektimit), që ata vetë do t'i përdorin dhe vlerësojnë në të ardhmen
Kërcënim menaxherial	Një gjë e tillë ndodh kur një inspektor kryen veprime që përfshijnë gjykime dhe vendime, të cilat në fakt janë përgjegjësi e menaxherve (për shembull vendosja e politikave dhe strategjive të menaxhimit të inspektimit).
Kërcënim familjarizimi	Një gjë e tillë ndodh kur marrëdhëniet midis inspektorëve dhe subjekteve që inspektohen bëhen, ose në dukje mund të bëhen shumë të afërta dhe si rrjedhojë nuk janë mjaft të besueshëm. Kjo mund të ndodhë kur inspektorët kanë kohë që e ushtrojnë funksionin e tyre në atë njësi territoriale
Kërcënim mbrojtës	Një gjë e tillë ndodh kur inspektorët mund të bëhen, ose duket sikur veprojnë si avokat mbrojtës ndaj ose kundër një subjekti që inspektohet.
Kërcënim nga frika/ kanosja	Një gjë e tillë ndodh kur inspektorët mund të jenë, ose duket se janë të frikësuar, ndaj kërcënimit nga një autoritet i fuqishëm dhe nga presione të tjera qofshin reale apo të hamendësuar, të cilat mund të ndikojnë në ndryshimin e sjelljes në një mënyrë që mund të kompromentojnë pavarësinë ose objektivitetin e gjykimit. Një kërcënim i tillë mund të vijë nga vetë subjekti që inspektohet ose nga grupe të tjerë interesi.

1.7 Inspektorët duhet të tregojnë se janë të pavarur dhe objektiv, pasi mund të ketë një sërë rastesh ku risku (kërcënimi) mund të jetë real ose perceptohet se pavarësia e inspektorit është në rrezik.

Shembuj të kërcënimeve dhe të veprimeve që duhen ndërmarrë për të zbutur ose minimizuar riskun, janë si më poshtë:

Risku	Veprimi i mundshëm zbutës për të minimizuar riskun
Kur një inspektor kryen shërbime pranë subjektit të inspektimit	Nuk kërkohet veprim i veçantë përderisa marrëdhënia midis inspektorëve dhe subjektit të inspektimit nuk është ndryshe nga marrëdhëniet me qytetarët e tjerë.
Kur një inspektor është mik i ngushtë i menaxherit më të lartë të subjektit të inspektimit	Inspektori nuk duhet të kryejë procedurë inspektimi në këtë subjekt inspektimi.
Kur një inspektor është një mik i ngushtë i një punonjësi që sapo ka filluar punë në subjektin e inspektimit	Inspektori nuk duhet të kryejë procedurë inspektimi, sidomos në fushën ku ky person punon
Kur një inspektor ka një konflikt të njohur me subjektin e inspektimit	Inspektori nuk duhet të kryejë procedurë inspektimi në këtë subjekt inspektimit.

Sqarim: Pavarësia e inspektorit përcaktohet si të qenurit i lirë nga kushtet që kërcënojnë objektivitetin ose të qenurit objektiv. Kërcënimet e objektivitetit duhet të menaxhohen në nivele individuale angazhimi, funksionimi dhe organizative të inspektorit.
Objektiviteti:
- *Nënkupton gjykimin e paanshëm që i mundëson inspektorëve të kryejnë kontrollet e subjekteve të inspektimit në mënyrë të tillë që të kenë besim përsa i përket produktit të punës të tyre dhe se nuk është bërë ndonjë kompromis përsa i përket cilësisë.*
- *Kërkon që inspektorët, për problemet e inspektimit, të mos varen në gjykimet e tyre nga të tjerët. Është shumë e rëndësishme që inspektorët të jenë të pavarur, por gjithashtu edhe të shihen nga të tjerët se janë të pavarur.*

Kryerja e inspektimit:
- *Duhet të zhvillohet sipas kuadrit ligjor e rregullator dhe Standardeve të propozuara nga Inspektoratet shtetërore dhe të miratuar nga Ministri përkatës dhe Inspektorati Qendror dhe nuk i nënshtrohet asnjë ndikimi tjetër nga individë me autoritet, qofshin këta brenda apo jashtë inspektoratit shtetëror.*

3. Mënyra e plotësimit të dokumentacionit (procesverbal, listë verifikimi)

3.1 Plotësimi i listës së verifikimit:
- Grupi i inspektimit verifikon të dhënat/dokumentacionin dhe plotëson listën tip të verifikimit.
- Lista e verifikimit plotësohet me saktësi, sipas verifikimit në moment.

Sqarim: "*Listë-verifikimi", është një dokument që përcakton përputhshmërinë me ligjin specifik për fushën e inspektimit që mbulon inspektoriati shtetëror përkatës. Listë-verifikimi plotësohet në të gjitha rubrikat përkatëse, përpara procesverbalit dhe është pjesë integrale e tij*".

3.2 Plotësimi i procesverbalit:

3.2.1 Procesverbali plotësohet nga inspektori në subjektin e inspektimit për inspektim dhe përfundohet duke respektuar kohëzgjatjen e qëndrimit në subjektin e inspektimit, të përcaktuar në autorizim.

3.2.2 Mënyra e mbajtjes së procesverbalit apo e një dokumenti tjetër të barasvlershëm me të:

- Procesverbali/inventarizimi mbahet në vendin e kryerjes së inspektimit dhe në kohën e konstatimit të saj, si rregull, në prani të subjektit të inspektuar ose përfaqësuesit të tij dhe të dëshmitarëve të pranishëm dhe nënshkruhet nga përpiluesi, subjekti i inspektimit/përfaqësuesi i tij dhe dëshmitarët e pranishëm, në rast se ka.

3.3 Në rast pamundësie për t'u mbajtur në vendin e kryerjes së inspektimit, procesverbali plotësohet në ambientin e punës nga inspektori, duke pasqyruar në mënyrë të detajuar sa është pasqyruar në listën e verifikimit, të mbajtur në vend.

- Në procesverbal shënohen identiteti i subjektit të inspektuar, gjetjet dhe lloji i kundërvajtjes, nëse konstatohet.
- Në rastet kur subjekti i inspektimit/përfaqësuesi i tij kundërshton nënshkrimin e procesverbalit, ky fakt evidentohet në atë procesverbal.
- Procesverbali plotësohet me saktësi, përpikmëri dhe pa korrigjime, me shkrim të qartë/lexueshëm.
- Procesverbali duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe duhet të mbulojë çdo fazë të procesit të inspektimit në subjektin e inspektimit.
- Procesverbali mbahet në 3 (tre) kopje dhe nënshkruhet nga inspektorët që e mbajnë atë bashkërisht.
- Përmbajtja e procesverbalit pasqyrohet në tabelën e inspektimit on-line dhe i dërgohet subjektit në formë elektronike në përputhje me rregullat e njoftimit të parashikuara në K. Pr. Administrative.

3.4 Në rast se përfaqësuesi i subjektit të inspektimit refuzon firmosjen e procesverbalit, trupa e inspektimit dërgon brenda 24 orëve procesverbalin e inspektimit dhe vendimin përfundimtar me postë në adresën e subjektit të inspektuar.

KAPITULLI III

Unifikimi i procedurave të inspektimit për monitorimin e të drejtave të pronësisë industriale

1. Inicimi i procedurës së inspektimit

Procedura e inspektimit, si një procedure administrative mund të fillojë:

*Me kërkesë-ankes*ë,

Ose

Ex-officio/kryesisht.

Këto dy forma të fillimit të inspektimit gjejnë rregullim edhe në ligjin e posaçëm të pronësisë industriale, ku është parashikuar se ISHMT-ja, me qëllim garantimin e të drejtave të pronësisë industriale, mund të veprojë kryesisht (*ex-officio*) ose mbi bazën e kërkesë-ankesës për inspektim të mbajtësit të së drejtës.

Sqarim: *Kodi i Procedurave Administrative parashikon se, fillimi i procedurës kryesisht është në diskrecionin e organit publik, dhe ky fundit është i detyruar të fillojë inspektimin kryesisht kur ligji ose akti nënligjor parashikon fillimin dhe/ose situata faktike është e tillë që procedura administrative për mbrojtjen e interesit publik. Për rrjedhojë, gjatë inspektimit ex-officio, duhen patur në konsideratë parashikimet e K.P.A.*

1.1 Inspektimi me ankesë-kërkesë

Forma dhe përmbajtja e kërkesës

Përveçse kur ligji parashikon një formë të caktuar, çdo kërkesë, me të cilën personat i drejtohen organit në një procedurë administrative, mund të jetë:

a) në formë të shkruar;

b) të deklarohet verbalisht para organit publik dhe të regjistrohet nga ky i fundit; ose

c) të bëhet në çdo formë tjetër të përshtatshme.

Kërkesa duhet të jetë mjaftueshëm e qartë për të përcaktuar kërkuesin dhe qëllimin e saj, përveçse kur ligji parashikon një përmbajtje të caktuar.

Kërkesa konsiderohet në formë të shkruar edhe kur ajo dërgohet me faks ose në rrugë elektronike, me kusht që të tregojë qartë autorin e saj.

Hapi I: Administrimi i ankesë-kërkesës

1. Marrja e ankesë-kërkesës

1.1 Ankesë-kërkesës regjistrohet pranë ISHMT-së, sipas rendit kronologjik të paraqitjes në një regjistër të posaçëm. Regjistri i kërkesave për fillimin e procedurës administrative përmban informacionin e mëposhtëm:

a) numrin e kërkesës;
b) datën e dorëzimit;
c) objektin e kërkesës;
ç) numrin dhe emërtimin e dokumenteve që i bashkëngjiten kërkesës; dhe
d) identitetin dhe adresën e kërkuesit.

1.2 Nëse dy ose më shumë kërkesa mbërrijnë me të njëjtën dërgesë postare pranë ISHMT-së, ato konsiderohen të depozituara pranë këtij organi, në të njëjtën kohë.

1.3 Në rast se, kërkesa paraqitet verbalisht nëpunësi vepron sipas pikës 1.1., të këtij manuali.

2. E drejta e plotësimit, ndryshimit dhe e tërheqjes së kërkesës-ankesës

2.1 Subjekti që ka dorëzuar një kërkesë mund ta plotësojë ose ndryshojë atë, vetëm kur qëllimi i kërkesës së ndryshuar bazohet në të njëjtën situatë faktike si kërkesa fillestare.

2.2 Subjekti ankues-kërkues, me anë të një kërkese me shkrim, mund të tërhiqet tërësisht ose pjesërisht nga procedura administrative dhe të heqë dorë nga të drejtat dhe interesat e saj ligjorë, përveç rasteve kur kjo ndalohet me ligj.

2.3 Ndryshimi apo tërheqja e kërkesës mund të kryhet në çdo kohë, për sa kohë që ISHMT nuk ka marrë një vendim përfundimtar.

2.4 Pas tërheqjes së subjektit, ISHMT vendos përfundimin e procedurës administrative. Në këtë rast, organi publik njofton palët e tjera, nëse ka.

2.5 Vendimi i ISHMT për t'i dhënë fund procedurës administrative, pas tërheqjes së subjektit, mund të ankimohet nga çdo palë tjetër.

2.6 Tërheqja e subjektit nuk çon në përfundimin e procedurës administrative, në rast se ISHMT vlerëson se vazhdimësia e procedurës është në interes publik ose në interesin e ligjshëm të palëve të tjera.

Hapi II: Verifikimi paraprak

3. Shqyrtimi i ankesë-kërkesës

3.1 Në fillim të procedurës administrative, struktura përgjegjëse për pronësinë industriale kryen verifikimet e mëposhtme:

a) nëse të drejtat apo interesat e kërkuara nga palët janë subjekt i ndonjë kufizimi kohor;
b) legjitimimin e palës që ka paraqitur kërkesën për fillimin e procedurës administrative;

c) nëse kërkesa e një pale për fillimin e një procedure administrative mund të shqyrtohen së bashku me kërkesat e palëve të tjera, nëse bazohet në të njëjtat fakte dhe bazë ligjore.

3.2 Pas vlerësimit të kërkesave formale kërkesë-ankesës vijon shqyrtimi i çështjeve të themelit.

4. Subjektet që legjitimohen për paraqitjen e kërkesë-ankesës

Të drejtën që të paraqitur pranë ISHMT-së një kërkesë-ankesë për inspektim për të filluar procedurat dhe veprimet përkatëse të inspektimit e gëzon:

a) Mbajtësi i së drejtës të pronësisë industriale,

ose

b) Përfaqësuesi i mbajtësit të së drejtës të pronësisë industriale.

5. Objekti i kërkesë-ankesë për inspektim

Kërkesë-ankesa që paraqitet pranë ISHMT-së, duhet të ketë si objekt të saj kërkesën për të ndërmarrë veprime lidhur me:

a) mallrat e falsifikuara;
b) mallrat pirate;
c) mallrat që dyshohet se shkelin një të drejtë të pronësisë industrial;
d) shkeljet e të drejtave të pronësisë industriale.

6. Përmbajtja e kërkesë-ankesës

6.1 Kërkesë-ankesa për inspektim paraqitet pranë ISHMT-së, në gjuhën shqipe dhe përfshin të paktën informacionin, si më poshtë:

<u>Të dhëna të detyrueshme</u>

a) të dhëna identifikuese për kërkuesin e kërkesë-ankesës për inspektim (emri, adresa dhe të dhënat e kontaktit të kërkuesit);
b) statusi i kërkuesit dhe të dhëna identifikuese për përfaqësuesin e tij, në rast se kërkesë-ankesa për inspektim paraqitet nëpërmjet përfaqësuesit (emri, adresa, të dhënat e kontaktit dhe provat që personi në fjalë ka kompetenca të veprojë në cilësinë e përfaqësuesit, sipas legjislacionit në fuqi);
c) e drejta apo të drejtat e pronësisë industriale që zbatohen, e cila/të cilat duhet të jenë regjistruar pranë DPPI-së;
d) të dhëna teknike dhe specifike për mallrat origjinale, duke përfshirë, por duke mos u kufizuar në: përshkrimin e mallrave, shenjat, bar-kodet, imazhet, mesatarja e vlerës në tregun kombëtar, karakteristikat dalluese të mallrave dhe çdo informacion tjetër të nevojshëm për identifikimin e mallrave origjinale;
e) informacionin e nevojshëm për t'u mundësuar autoriteteve inspektuese të identifikojnë mallrat origjinale, i tillë si informacioni për vendin e prodhimit të mallrave origjinale;
f) informacionin e nevojshëm për autoritetet inspektuese për analizën dhe

vlerësimin e riskut të shkeljes së të drejtës apo të të drejtave të pronësisë industriale, i tillë si informacioni për shoqëritë e përfshira në tregtimin e mallrave origjinale apo distributorët e autorizuar.

Të dhëna opsionale/vullnetare:

a) të dhëna identifikuese për mbajtësin/tregtarin e mallrave që dyshohet se shkel të drejtat e pronësisë industriale, të tilla si: emri, adresa, emri tregtar, NIPT-i/NUIS[10], etj.;
b) të dhëna teknike dhe specifike për mallrat cënuese;
c) çdo informacion tjetër shtesë të nevojshëm për identifikimin e mallrave cenuese.

7. Dokumentacion shoqërues[11]

Dokumentacion shoqërues, konsiderohet, por pa u kufizuar:

a) dokumentet që provojnë se kërkuesi-ankuesi është mbajtës i një të drejte, në kuptim të ligjit për pronësinë industriale, të tilla si:
   i. ekstrakte të lëshuara nga DPPI-ja për regjistrimin e një të drejte të pronësisë industriale;
   ii. certifikata të regjistrimit apo të ripërtëritjes së një të drejte të pronësisë industriale;
   iii. licencë ekskluzive për përdorimin e të drejtës së pronësisë industriale etj.
b) autorizimi i përfaqësimit të lëshuar nga mbajtësi i së drejtës, në rast se kërkesë-ankesa për inspektim paraqitet nëpërmjet përfaqësuesit të tij;
c) çdo dokument tjetër provues në ndihmë të autoriteteve inspektuese dhe/ose mostra apo riprodhime të ndryshme të mallrave cënuese.

Hapi III: Trajtimi i kërkesë-ankesës dhe verifikimi i dokumentacionit shoqërues

8. Trajtimi i kërkese-ankesës

8.1 Brenda 10 (dhjetë) ditëve punë nga data e dorëzimit të kërkesë-ankesës, kërkesë-ankesa për inspektim shqyrtohet nga struktura përgjegjëse e pronësisë intelektuale dhe industriale, pranë ISHMT-së.

8.2 Nëse kërkesë-ankesa nuk përmban të gjithë informacionin e kërkuar[12], ISHMT, i kërkon kërkuesit që të vërë në dispozicion brenda 10 (dhjetë) ditëve punë nga data e marrjes së njoftimit informacionin që mungon. Në rast se, kërkuesi-ankuesi nuk vë në dispozicion informacionin e munguar brenda afatit të ISHMT-ja refuzon kërkesë-ankesën për inspektim.

8.3 ISHMT-ja, brenda 20 ditëve punë nga data e dorëzimit të kërkesë-ankesës dhe informacionit të plotë ligjor, ka detyrimin që të kryejë verifikime në treg dhe pranë

[10] Numri Unik i Identifikimit të Subjektit

[11] Dokumentacioni paraqitet në kopje origjinale ose të njësuar me origjinalin. Të gjitha dokumentet duhet të jenë të përkthyera në gjuhën shqipe

[12] Trajtuar në pikën 6, të Manualit.

ambienteve të mbajtësit/tregtarit të mallrave që dyshohet se shkelin të drejtat e pronësisë industriale, në rast se kërkuesi ka paraqitur të dhëna konkrete mbi të.

8.4 Në rast se kërkuesi nuk ka paraqitur të dhëna konkrete për mbajtësit/tregtarin e mallrave, që dyshohet se shkel/in të drejtat e pronësisë industriale, ISHMT-ja ka të drejtë të vijojë me verifikimet dhe inspektimet në treg bazuar në informacionin e paraqitur në kërkesë-ankesën për inspektim, duke njoftuar kërkuesin për çdo subjekt të identifikuar e të supozuar si shkelës të të drejtave të pronësisë industriale.

8.5 ISHMT-ja ka të drejtë të vendosë bllokimin e përkohshëm të mallrave që dyshohet se shkelin një të drejtë të pronësisë industriale dhe heqjen e tyre përkohësisht nga tregu. Bllokimi i mallrave do të kryhet pranë ambienteve të subjektit, duke vendosur nxjerrjen e menjëhershme nga tregu dhe ndalimin e përkohshëm të tregtimit të tyre. ISHMT-ja përpilon e mban procesverbalin/inventarin përkatës për natyrën dhe sasinë e mallit të bllokuar, duke i bashkëlidhur edhe pamjet fotografike që dokumentojnë bllokimin. Inventari dhe pamjet fotografike bëhen pjesë e praktikës përkatëse në sistemin e-inspektimi.

8.6 Në rast se mbajtësi/tregtari i mallrave kundërshton bllokimin e mallrave dhe demonstron apo provon ligjërisht nëpërmjet dokumenteve përkatëse se mallrat nën posedimin/përdorimin e tij janë origjinale, ISHMT-ja revokon vendimin për bllokimin e përkohshëm të mallrave dhe njofton menjëherë kërkuesin brenda 3 (tri) ditësh nga data e marrjes së vendimit të revokimit. Kundër vendimit të revokimit mund të paraqitet ankim sipas legjislacionit në fuqi.

9. Verifikimi i dokumentacionit shoqërues

9.1 Në aspektin formal dokumentacioni shoqërues:

- Duhet të jetë në origjinal ose kopje e njësuar me origjinalin;
- Duhet të jetë në gjuhën shqipe;
- Duhet të mos përmbajë korrigjime ose fshirje të pavërtetuara;
- Përmbajtja e tij duhet të jetë e dallueshme qartë dhe e lexueshme.

Sqarim: *Referuar nenit 39 të ligjit nr.10433/2011, gjatë procesit të inspektimit, Inspektori ka të drejtë:*

- të kërkojë dhe të marrë kopje të dokumenteve të veprimtarisë, në përputhje me objektin e inspektimit, ku çdo kopje dokumenti, i marrë, nënshkruhet nga përfaqësuesi i subjektit të inspektuar;
- *ka të drejtë të sekuestrojë dokumente që lidhen me objektin e inspektimit, me qëllim verifikimin e autenticitetit apo korrektësisë së informacionit.*

Në rast se mbajtësi i të drejtave të mbrojtura nga legjislacioni për pronësinë industriale vepron nëpërmjet përfaqësuesit të tij, forma e autorizimit do të jetë në përputhje me nenet 64, dhe në vijim të Kodit Civil.

9.2 Në aspektin material, dokumentacioni shoqërues konsiston në:

9.2.1 Për subjektet shqiptare:

- Dokumentet/ autorizimet, duhet të jenë të nënshkruara nga përfaqësuesi i

mbajtësit të së drejtës dhe të mbajnë vulën e subjektet (nëse subjekti disponon vulë[13]).

9.2.2 Për subjektet e huaja:

- Dokumentet shoqëruese duhet të jenë në gjuhën shqipe.
- Së bashku me dokumentin shoqërues në shqip, dokumentet e huaja që do të paraqiten nga subjekti i inspektuar pranë ISHMT-së, duhet të jenë të legalizuara në përputhje me VKM nr. 134, datë 07.03.2003.
- Dokumentet e paraqitura nga vendet anëtare të Konventës së Hagës, "Për heqjen e detyrimit të legalizimit të dokumenteve zyrtare të huaja" të 5 tetorit 1961, pranohen dokumentet e apostiluara.
- Për vende si: Hungaria, Republika Çeke, Rumania, Rusia, Sllovakia, Bullgaria dhe Kosova), dokumentet pranohen direkt pa pasur nevojë të legalizohen apo apostilohen[14].

10. Shqyrtimi dhe verifikimi i kërkesë-ankesës

Pas vlerësimit të elementeve dhe kërkesave formale paraprake të kërkesë-ankesës, dhe dokumentacionit shoqërues, struktura përgjegjëse pranë ISHMT-së, verifikon:

a) faktin nëse personi, është person i legjitimuar për të paraqitur kërkesë-ankesën;
b) plotësimin e të gjitha të dhënave të detyrueshme të kërkuara, si dhe dokumentet shoqëruese;
c) paraqitjen, në formën e kërkuar, të dokumentacionit shoqërues, që vërteton të dhënat për të cilën paraqitet kërkesë-ankesa;
d) faktin nëse të dhënat e shprehura në kërkesë-ankesë nuk kundërshtojnë, në mënyrë të dukshme, të dhënat që përmbajnë dokumentet, që shoqërojnë kërkesë-ankesën;
e) faktin nëse dokumentacioni i paraqitur nuk përmban korrigjime ose fshirje të pavërtetuara, si dhe kur nëse përmbajtja e tij duket qartë, është e lexueshme;
f) formën e akteve shoqëruese, nëse janë në origjinal apo kopje e njësuar me origjinalin.

Hapi IV: Nxjerrja e autorizimit të inspektimit

11. Veprimet procedurale:

11.1 *Propozimi i inspektimit*: Drejtoria përgjegjëse, sipas kërkesë-ankesës propozon pranë Kyenspektorit nxjerrjen e autorizimit të inspektimit me anë të një relacioni shpjegues.

11.2 *Miratimi i autorizimit nga Kryeinspektori*: Kryeinspektori miraton autorizimin për inspektimin, në të cilin përcaktohen të paktën, këto elemente:

a) inspektorati shtetëror apo vendor përkatës, që lëshon autorizimin;
b) objekti i inspektimit;
c) baza ligjore;

[13] Neni 72, paragrafi II: "Prokura në emër të personave juridikë publikë e privatë mud të bëhet edhe vetëm me nënshkrimin e drejtuesit të tij dhe me vulën përkatëse, përveç kur ligji kërkon që veprimi juridik të kryhet me akt noterial.".

[14] https://punetejashtme.gov.al/legalizimi-dhe-apostilimi-i-dokumenteve/

ç) data dhe vendi i lëshimit;
d) identiteti i inspektorit apo i inspektorëve të autorizuar për të kryer inspektimin;
dh) identiteti i personave të tjerë të autorizuar për kryerjen e veprimeve ndihmëse;
e) emri apo emërtimi dhe adresa e subjektit të inspektimit, të dhëna për përcaktimin sa më të qartë të tij, në rastin e inspektimit rastësor, apo të dhëna për përcaktimin sa më të saktë të veprimtarisë konkrete që i nënshtrohet inspektimit, në rast se emri, emërtimi dhe adresa nuk janë të njohura;
ë) kohëzgjatja në ditë për kryerjen e inspektimit;
f) vendi apo vendet ku do të kryhet inspektimi;
g) të dhënat e identifikimit, pozicioni dhe nënshkrimi i personit që ka lëshuar autorizimin.

Hapi V: Njoftimi paraprak i autorizimit

12. Si rregull, ISHMT, jo më vonë se 3 (tri) ditë përpara fillimit të veprimeve të inspektimit, njofton subjektin që do t'i nështrohet procedurave të kontrollit.

13. Për shkak të natyrës sensitive të shkeljeve të të drejtave që derivojnë nga pronësia industriale, të cilat mund të fshihen nga ana e subjektit të inspektimit, inspektimi mund të kryhet pa bërë njoftim paraprak. Në këtë rast, nga ana e personit përgjegjës që lëshon autorizimin, gjatë motivimit të "mosnjoftimit paraprak të autorizimit" duhet të mbahen në konsideratë elementësi: risku i objekteve të inspektimit përkatës, ashtu dhe cënimin e detyrimit për respektimin e të drejtave në pronësinë industriale.

Treguesit (vlerat) e faktorëve të riskut të cënimit lidhen me efektin e papërputhshmërisë së objekteve të inspektimit dhe agregohen në një shumatore të përgjithshme, duke përcaktuar vlerën e treguesit të përgjithshëm të riskut për çdo objekt inspektimi (Risku i Objekteve).

***Konkretisht, njoftimi paraprak nuk kryhet në këto raste:**

a) kur ekziston rreziku që njoftimi mund të pengojë kryerjen me efektivitet të inspektimit;
b) kur mosnjoftimi përcaktohet shprehimisht nga ligji i posaçëm;
c) për inspektimin për verifikimin e korrigjimit të shkeljeve në përfundim të afatit të përcaktuar, sipas pikës 4, të nenit 48, të ligjit nr. 10433/2011[15];
ç) për inspektimet e parashikuara në pikën 2 të nenit 26[16], të ligjit nr. 10433/2011;
d) për inspektimin rastësor.

14. Mosnjoftimi paraprak i inspektimit, sipas shkronjës "a" të pikës 13, të këtij manuali, vendoset nga personi që lëshon autorizimin dhe pasqyrohet në autorizim. Vendimi i mosnjoftimit paraprak duhet të motivohet.

[15] "4. Kur është e nevojshme, dënimi administrativ shoqërohet me urdhërimin e subjektit të inspektimit për të korrigjuar shkeljet e konstatuara dhe për të eliminuar pasojat e tyre, duke përcaktuar dhe një afat të arsyeshëm për këtë qëllim. Vendimi i dënimit përfshin këshillimin me shkrim të subjektit për mënyrën e korrigjimit të shkeljeve që pasqyrohet në një fletë shoqëruese.".

[16] "Inspektimet vjetore për kategori të ndryshme të subjekteve të inspektimit".

***Sqarim**: Mosnjoftimi paraprak nuk prek thelbin e të drejtës për t'u njohur dhe për të parashtruar shpjegime dhe dokumentet që disponon për të provuar përputhshmërinë e mallrave /produkteve më kërkesat e legjislacionit në fuqi, për pronësinë industriale.*

Në rast të mosnjoftimit paraprak, inspektimi njoftohet njëkohësisht me fillimin e veprimeve të inspektimit, nëpërmjet:

- dorëzimit të autorizimit, përfaqësuesit të subjektit të inspektimit, në rastet e parashikuara në shkronjat "a" - "c" të pikës 13 të këtij manuali. Në rast të refuzimit të marrjes së autorizimit apo mosgjetjes së personit përfaqësues, inspektori e afishon autorizimin në vendin ku kryhet inspektimi dhe ky fakt pasqyrohet në procesverbal.
- njoftimit me gojë në rastet e tjera.

***Sqarim:** Për përllogaritjen e afatit të mbahet në konsideratë rregullat e përcaktuara në Kodin e Procedurave Administrative, sipas të cilave kur afati caktohet në ditë, në llogaritjen e tij përjashtohet dita kur ka ndodhur ngjarja, nga e cila fillon të ecë afati, si dhe të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj.*

Hapi VI: Hetimi administrativ (Inspektimi)

15. Verifikimi pranë subjektit dhe barra e proves

15.1 Inspektimi kryhet ne vendin ku subjekti ushtron aktivitetin e tij tregtar ose në vendin ku ndodhen mallrat objekt inspektimi, përcaktuar në autorizimin e inspektimit.

15.2 Grupi i inspektimit paraqitet pranë subjektit, duke bërë me dije fillimisht:

i. Prezantimin dhe paraqitjen e kartës së inspektorit[17], shoqëruar me dokument identifikimi. Inspektori, gjatë gjithë kohës së inspektimit mban në një vend të dukshëm "*Kartën e Inspektorit*" të lëshuar nga Inspektorati Qendror;
ii. Autorizimin dhe arsyen e inspektimit;
iii. I bën me dije subjektit procedurën e inspektimit;
iv. I komunikon subjektit të inspektimit të drejtat dhe detyrat, si dhe pasojat e moszbatimit të tyre.

15.3 Pas prezantimit, grupi i inspektimit kërkon fillimisht nga subjekti shpjegime dhe dokumente për origjinën e mallrave, për të provuar e vërtetuar se mallrat në fjalë janë origjinale.

15.4 Në rast se dokumentacioni i vënë në dispozicion vlerësohet nga grupi i punës si i paplotë, kërkon nga mbajtësi/tregtari i mallrave të paraqesë shpjegimet dhe dokumentet mbështetëse shtesë brenda 5 (pesë) ditëve punë, pranë ISHMT-së.

[17] Kartën e miratuar nga Inspektorati Qëndror.

Barra e provës në këtë rast i takon mbajtësit/tregtarit të mallrave.

15.5 Në çdo rast, nëse mbajtësi/tregtari i mallrave nuk jep shpjegime, dhe grupi i inspektimit vlerëson se, mallrat janë të dyshuara që shkelin një të drejtë të pronësisë industriale vendos masën e bllokimit të përkohshëm të mallrave që dyshohet se shkelin një të drejtë të pronësisë industriale.

Sqarim: *Vendi i inspektimit përcaktohet në autorizim. Vendi i inspektimit mund të jetë:*
a) kudo ku kryen veprimtarinë e tij subjekti i inspektimit dhe ndodhen faktet që lidhen me respektimin apo mosrespektimin e kërkesave ligjore;
b) në zyrat e organit inspektues, nëse nga natyra e inspektimit është i mundur të kryhet inspektimi.

16. Verifikimi i mallrave nga grupi i inspektimit

16.1 Grupi i inspektimit, verifikon, sipas rastit:

a) Për mallra të falsifikuara:

i. verifikimin nëse mallrat, të cilat janë objekt i një veprimi që shkel një markë tregtare dhe, pa lejen e mbajtësit të së drejtës, mbajnë një shenjë identike me markën tregtare të regjistruar rregullisht për të njëjtat lloje mallrash ose që në thelb është e padallueshme nga kjo markë;

ii. mallra, të cilat janë objekt i një veprimi që shkel një tregues gjeografik/ emërtim origjine dhe mbajnë ose janë të përshkruara me një emër ose term të mbrojtur lidhur me atë tregues gjeografik/emërtim origjine;

iii. çdo paketim, etiketë, ngjitës, broshurë, udhëzues përdorimi, dokument garancie ose artikull tjetër i ngjashëm, edhe nëse paraqitet veçmas, që është objekt i një veprimi që shkel një markë tregtare ose një tregues gjeografik/ emërtim origjine, që përfshin një shenjë, emër ose term që është identik me një markë tregtare të regjistruar rregullisht ose tregues gjeografik/emërtim origjine të mbrojtur, ose që në thelb është e padallueshme nga një markë tregtare apo tregues gjeografik/emërtim origjine i tillë dhe që mund të përdoret për të njëjtin lloj mallrash si ai për të cilin është regjistruar marka tregtare ose treguesi gjeografik/emërtim origjine.

b) Lidhur me procedurën e verifikimit dhe kontrollit përkatës, në mënyrë të përmbledhur kjo veprimtari administrative ezaurohet sipas këtyre hapave, në rend kronologjik:

i. Inspektimi në vendin ku subjekti i inspektimit mban mallin, objekt kontrolli, në përdorim të tij;

ii. Mbahet procedverbali përkatës në të cilin evidentohen:sasia, lloji i produktit dhe marka apo disenjo që mbajnë;

iii. Në vijim, subjektit i kërkohet të paraqesë para Grupit të Inspektimit dokumenta[18] që vërtetojnë se mallrat nuk janë të falsifikuara;

[18] Ku përfshihen por pa u kufizuar autorizime, fatura,deklarata, kontrata furnizimi apo porosie etj

iv. Verifikimi dhe shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur vijon seri në momentin që vërtetohet lidhja midis mallit, markës përkatëse dhe pronarit të markës;

Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të paraqiten të përkthyera në shqip, në përputhje me K.Pr. Administrative dhe të njësuara me origjinalin.

Koment: *Procesi i marrjes së mostrave dhe kontrollit të produketeve do të kryehet nga Grupi i Inspektimit në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 10433/2011 dhe manualit të inspektimit të përgjithshëm, të miratuar me urdhërin nr. 13, datë 23.04.2015. Ky proces kontrolli nuk mund të referojë në numur apo sasi malli të përcaktuar në mënyrë koncize, por vereifikohet dhe veprohet rast pas rasti, sa kohë që, objekt kontrolli mund të jetë edhe vetem nje produkt qe cenon te drejtat e pronesise industriale dhe për sa kohë ky produkt ka vlerë, cënon eventualisht në thelb të drejtat e mbajtesit të së drejtës.*

Për mallra pirate:

i. mallra, të cilat janë objekt i një veprimi që shkel të drejtat e një disenjoje industriale në Republikën e Shqipërisë dhe janë/ose përmbajnë kopje të bëra pa pëlqimin e mbajtësit të të drejtave të lidhur me disenjon industriale apo të një personi të autorizuar prej mbajtësit në vendin e prodhimit.

c) Për mallra që dyshohet se shkelin një të drejtë të pronësisë industriale, të cilat janë mallra të identifikuara në Republikën e Shqipërisë, të cilat, në pamje të parë, kanë tregues të arsyeshëm se:

i. janë objekt i një veprimi që shkel një të drejtë të pronësisë industriale në Republikën e Shqipërisë;

ii. kanë pajisje, produkte apo komponentë që janë projektuar, prodhuar ose përshtatur, kryesisht me qëllim për të mundësuar apo lehtësuar shmangien nga çdo teknologji, pajisje apo komponent, që në rrjedhën normale të operacionit të tij parandalon ose kufizon veprime lidhur me vepra të paautorizuara nga mbajtësi i të drejtave të pronësisë industriale dhe që lidhet me një veprim që shkel këto të drejta në Republikën e Shqipërisë;

iii. kanë çdo format apo matricë të disenjuar apo të përshtatur specifikisht për prodhimin e mallrave që shkelin të drejtën e pronësisë industriale, nëse këto formate apo matrica lidhen me një veprim që shkel të drejtën e pronësisë industriale në Republikën e Shqipërisë.

16.2 Lidhur me verifikimin e ekzistencës së shkeljes së të drejtave, Kërkuesi duhet të sigurojë, brenda afateve ligjore përkatëse të gjithë informacionin e nevojshëm ku mbështetet ankesa e tij lidhur me:

a) ekzistencën e të drejtave të pronësisë industriale;
b) mbajtësit e regjistruar të të drejtave të tilla apo përfaqësuesve të tyre në Republikën e Shqipërisë;
c) çdo të dhënë tjetër lidhur me mallrat origjinale apo mallrat që dyshohet se shkelin një të drejtë të pronësisë industriale.

ISHMT-ja mund të kërkojë shpjegime dhe dokumente mbështetëse për origjinën e mallrave nga mbajtësi/tregtari i mallrave që dyshohet se shkelin një të drejtë të pronësisë industriale në mënyrë që ky i fundit të provojë dhe të vërtetojë se mallrat janë origjinale. Shpjegimet dhe dokumentet mbështetëse të kërkuara vendosen në dispozicion të ISHMT-së brenda 5 (pesë) ditëve punë nga data e njoftimit.

16.3 Grupi i inspektimit bën vlerësimin e dokumenteve që provojnë se kërkuesi është mbajtës i një të drejte në kuptim të ligjit të PI-së, të tilla si ekstrakte të lëshuara nga DPPI-ja për regjistrimin e një të drejte të pronësisë industriale, certifikata të regjistrimit apo të ripërtëritjes së një të drejte të pronësisë industriale, licencë ekskluzive për përdorimin e të drejtës së pronësisë industriale etj, autorizimin e përfaqësimit të lëshuar nga mbajtësi i së drejtës në rast se kërkesë-ankesa për inspektim paraqitet nëpërmjet përfaqësuesit të tij, dhe në rast se është e mundur, çdo dokument tjetër provues në ndihmë të autoriteteve inspektuese dhe/ose mostra apo riprodhime të ndryshme të mallrave cenuese që vërteton se mallrat janë origjinale.

16.4 Nëse, grupi i inspektimit konstaton se, mallrat shkelin një të drejtë të pronësisë industriale, vendosin bllokimin e mallrave, shoqëruar me inventarizimin e saktë të tyre, dhe materiale fotografike dhe/ose video regjistrime.

16.5 Në përfundim të hetimit, grupi i inspektimit dokumenton të gjithë veprimet e kryera, si dhe dokumentacionin e administruar, në kuadër të hetimit administrativ, dhe bën pasqyrim të plotë në procesverbal.

16.6 ISHMT, i komunikon subjektit të përfshirë në procedurën administrative, veprimin administrativ ose veprimin procedural, duke i vënë në dispozicion aktin përkatës (procesverbal/inventar).

***Sqarim:**. Inspektori vlerëson në bazë të verifikimeve përkatëse sipas ligjit, nëse mallrat janë të falsifikuara ose jo dhe nëse Përdoruesi ka autorim per përdorimin e këtyre mallrave. Por, inspektori nuk mund të shprehet mbi vlefshmërinë e një dokumenti, në kuptim të origjinalitetit apo falsitetitit të tij pasi në këtë rast do të rezikonte të ishte në situatën e tejkalimit të kompetencave. Në rast të dyshimimeve të arsyeshme, Grupi i Inspektimit mund të referojë* çështjen në Prokurori, si organi kompetent për tu shprehur në lidhje me ekzistencën e veprës së falsifikimit të dokumentacionit origjinal. Në *përputhje me parimin e përgjegjësisë ligjore individuale, personi që vendos në dispozion të Grupit të Inspektimit dokumentacionin e kërkuar, mban përgjegjësi për vërtetësinë e tij.*

17. Dokumentimi i gjithë veprimeve të kryera gjatë hetimit administrativ

Grupi i inspektimit:

17.1 Plotëson listë-verifikimin e miratuar nga Inspektorati Qëndror.

Pjesë e rëndësishme e dokumentacionit për dokumentimin e veprimtarisë inspektuese është edhe Listë-verifikimi, i cili përshtatet nga Inspektorati shtetëror sipas ligjit specifik dhe fushave të inspektimit për të cilat është përgjegjës.

Listë-verifikimi, përcakton në mënyrë të menjëhershme gjetjet në subjekt dhe përmban:

i. verifikimin nëse operatori ekonomik ka autorizim nga pronari i patentës së regjistruar për përdorimin, ofrimin për shitje, shitjen ose importimin e produktit/ proces;
ii. verifikimin nëse operatori ekonomik ka autorizim nga pronari i disenjos të prodhojë, të ofrojë, të importojë, të eksportojë, të hedhi në treg, të furnizojë, të shpërndajë, të përdorë ose të mbajë në ruajtje apo zotërim, për këto qëllime, çdo produkt, në të cilin është përfshirë disenjoja ose mbi të cilin është aplikuar;
iii. verifikimin nëse operatori ekonomik ka autorizim nga pronari i markës së regjistruar;
iv. verifikimin nëse operatori ekonomik është pronar i treguesit gjeografik të regjistruar;
v. verifikimin nëse subjekti i inspektimit përmbush kriteret ligjore lidhur me formën dhe përmbajtjen e autorizimeve, faturave, deklaratave, kontratave të furnizimit apo porosisë dhe çdo dokumenti tjetër të detyrueshmë për operatorët sipas objektit përkatës së veprimtarisë;
vi. verifikimin mbi të dhënat teknike dhe specifike për mallrat cënuese;
vii. verifikimin e të dhënave teknike dhe specifike për mallrat origjinale, duke përfshirë, por duke mos u kufizuar në: përshkrimin e mallrave, shenjat, bar-kodet, imazhet, mesatarja e vlerës në tregun kombëtar, karakteristikat dalluese të mallrave dhe çdo informacion tjetër të nevojshëm për identifikimin e mallrave origjinale, etj.

Sqarim: *Objektet e inspektimit janë grup produktesh të grupuara në listë verifikimi sipas funksionit që kryejnë në subjektet e inspektimit. Elementët shterues të listës së verifikimit do të varen nga objekti konkret i inspektimit.*

17.2 Fotografon gjendjen e subjektit në çastin e inspektimit.

a) Dokumenton të gjitha veprimet e ndërmarra në procesverbal/inventar, i cili nënshkruhet nga grupi i inspektimit përgjegjës dhe regjistrohet në regjistrin elektronik të institucionit.
b) Në procesverbal pasqyron të gjitha veprimet e kryera nga grupi i inspektimit, dokumentacioni i verifikuar dhe detyrat e lëna lidhur me dokumentacionin dhe/ ose shpjegimet shtesë të kërkuara, si dhe afatin e akorduar për plotësimin e tyre.
c) Kohëzgjatja e inspektimit fillon me hyrjen e inspektorit në mjediset, objektet, ku ushtron veprimtarinë subjekti i inspektimit.
d) Pas plotësimit të listë-verifikimit, inspektori/grupi i inspektimit fillon plotësimin e procesverbalit të inspektimit.
e) Data e mbylljes së procesverbalit presupozon përfundimin e afatit të qëndrimit në subjektin që inspektohet, në rastet kur procesverbali ka mundësi të përfundohet

në subjekt. Në rastet e tjera procesverbali mbyllet në ambientet e punës së grupit të inspektimit, dhe i komunikohet subjektit brenda 5 (pesë) ditëve.

18. Njoftimi i mbajtësit të së drejtës ose përfaqësuesin e autorizuar

18.1 Në rast se, grupi i inspektimit, në përfundim të hetimit, si dhe bazuar në dokumentacionin provues të administruar gjatë procesit të hetimit administrativ konkludon se, ekziston dyshimi i arsyeshëm se, mallrat shkelin një të drejtë të pronësisë industriale, vendos bllokimin e mallrave, shoqëruar me inventarizimin e saktë të tyre, materiale fotografike dhe/ose video regjistrime.

18.2 Grupi i inspektimit, ka të drejtë të vendosë bllokimin e përkohshëm të mallrave që dyshohet se shkelin një të drejtë të pronësisë industriale dhe heqjen e tyre përkohësisht nga tregu, dhe njofton mbajtësin e së drejtës ose përfaqësuesin e autorizuar të tij për masën e përkohshme. Njoftimi i ISHMT-së përfshin, duke mos u kufizuar në: natyrën dhe sasinë reale ose të vlerësuar të mallrave, pamje fotografike, mostra apo riprodhime të mallrave etj. Njoftimi bëhet në një nga adresat e poshtë cituara:

i. vendbanimin ose vendqëndrimin e marrësit;
ii. çdo vend, ku marrësi ndodhet, përfshirë dhe institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale;
iii. selinë ose çdo vend ku ushtron veprimtarinë marrësi, nëse ky i fundit është person juridik;
iv. vendin e punës;
v. vendin e ushtrimit të veprimtarisë ose zyrën e marrësit;
vi. çdo vend tjetër i specifikuar dhe i njoftuar paraprakisht nga pala.

18.3 Mbajtësi/tregtari i mallrave cënuese nënshkruan një deklaratë me anë të së cilës ai pranon shkatërrimin e mallrave në përdorim/posedim brenda 5 (pesë) ditëve punë nga data e njoftimit të vendimit të ISHMT-së.

18.4 Kur mbajtësi/tregtari i mallrave cenuese nuk ka dhënë me shkrim pëlqimin e tij për shkatërrimin e mallrave dhe as nuk ka kundërshtuar vendimin e shkatërrimit të këtyre mallrave brenda 5 (pesë) ditëve punë nga data e njoftimit të vendimit, ISHMT-ja prezumon se mbajtësi/tregtari i mallrave ka dhënë pëlqimin për shkatërrimin e mallrave.

18.5 Në rast se mbajtësi/tregtari i mallrave kundërshton bllokimin e mallrave dhe demonstron apo provon ligjërisht nëpërmjet dokumenteve përkatëse se mallrat nën posedimin/përdorimin e tij janë origjinale, ISHMT-ja revokon vendimin për bllokimin e përkohshëm të mallrave dhe njofton menjëherë kërkuesin brenda 3 (tri) ditësh nga data e marrjes së vendimit të revokimit.

Shkatërrimi i mallrave organizohet nën mbikëqyrjen e ISHMT-së jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike nga data e marrjes së vendimit të shkatërrimit. Kostot e lidhura me shkatërrimin e mallrave cënuese janë në ngarkim të kërkuesit.

Hapi VII: Vijimi i procedurave administrative

ISHMT, vendos, sipas rastit:

- Bllokimin përfundimtar dhe shkatërrimin e mallrave cënuese;

ose

- Revokimin e bllokimit te përkohshëm, dhe lirimin e mallrave.

19. Bllokimi përfundimtar dhe shkatërrimi i mallrave cënuese

19.1 Në përfundim të procedurave verifikuese përkatëse dhe të veprimeve të përcaktuara më sipër, ISHMT, vendos vijimin e procedurave për bllokimin përfundimtar dhe shkatërrimin e mallrave cënuese, në rast se:

a) Merr konfirmimin me shkrim nga mbajtësi i së drejtës;

dhe

b) Mbajtësi/tregtari i mallrave nuk kundërshton vendimin e shkatërrimit.

19.2Vendimi i marrë nga ISHMT-ja i njoftohet kërkuesit dhe mbajtësit të identifikuar të të drejtave dhe mbajtësit/tregtarit të mallrave, duke i komunikuar gjithashtu se, kostot e shkatërrimit janë në ngarkim të kërkuesit.

19.3 Brenda 5 (pesë) ditëve punë nga data e njoftimit të vendimit të ISHMT-së, mbajtësi/tregtari i mallrave cënuese nënshkruan një deklaratë me anë të së cilës ai pranon shkatërrimin e mallrave në përdorim/posedim.

19.4 Kur mbajtësi/tregtari i mallrave cënuese nuk ka dhënë me shkrim pëlqimin e tij për shkatërrimin e mallrave dhe as nuk ka kundërshtuar vendimin e shkatërrimit të këtyre, mallrave brenda 5 (pesë)ditëve punë nga data e njoftimit të vendimit, prezumohet se mbajtësi/tregtari i mallrave ka dhënë pëlqimin për shkatërrimin e mallrave.

19.5 Jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike nga marrja e vendimit të shkatërrimit, organizohet shkatërrimi i mallrave nën mbikëqyrjen e ISHMT-së.

20. Procesi i shkatërrimit[19] të mallrave

20.1 Në rastin kur, ISHMT, disponon me vendim përfundimtar për shkatërrimin e mallrave, atëherë:

a) Brenda 5 (pesë) ditëve punë nga data e njoftimit të vendimit të ISHMT-së, subjekti nënshkruan një deklaratë me anë të së cilës ai pranon shkatërrimin e mallrave në përdorim/posedim,

ose

b) Shkatërrimi vijohet pa pëlqimin e shprehur të mbajtësit/tregtarit të mallrave

[19] Shkatërrimi i mallrave organizohet nën mbikëqyrjen e ISHMT-së jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike nga data e marrjes së vendimit të shkatërrimit. Kostot e lidhura me shkatërrimin e mallrave cenuese janë në ngarkim të mbajtësit të të drejtave.

cënuese. Kur subjekti i inspektuar nuk ka dhënë me shkrim pëlqimin e tij për shkatërrimin e mallrave dhe as nuk ka kundërshtuar vendimin e shkatërrimit të këtyre mallrave brenda 5 (pesë) ditëve punë nga data e njoftimit të vendimit, ISHMT-ja prezumon se subjekti ka dhënë pëlqimin për shkatërrimin e mallrave/ miratim i heshtur.

20.2 Kur mbajtësi/tregtari i mallrave refuzon dhe kundërshton shkatërrimin e mallrave të bllokuar brenda afatit 5 (pesë) ditor nga data e njoftimit të vendimit të ISHMT-së, kjo e fundit njofton menjëherë kërkuesin, duke i komunikuar qëndrimin e mbajtësit/ tregtarit të mallrave.

20.3 Nëse mbajtësi/tregtari i mallrave refuzon dhe kundërshton shkatërrimin e mallrave të bllokuara brenda afatit 5 ditor të përcaktuar në pikën 21.2, ISHMT-ja njofton menjëherë kërkuesin. Kërkuesi brenda 20 (njëzet) ditëve punë nga data e marrjes së njoftimit të ISHMTsë duhet të fillojë procedimin gjyqësor për shkelje të të drejtave të pronësisë industriale pranë gjykatës kompetente.

Kërkuesi brenda 20 (njëzet) ditëve punë nga data e marrjes së njoftimit të ISHMT-së duhet të njoftojë, gjithashtu, ISHMT-në për ngritjen e padisë në gjykatë duke paraqitur një kopje të kërkesë-padisë përkatëse.

20.4 Në rast se kërkuesi depoziton kërkesë-padinë për shkelje të të drejtave në gjykatën kompetente dhe paraqet njëkohësisht kopjen e kërkesë-padisë në fjalë pranë ISHMT-së brenda 20 (njëzet) ditëve punë nga data e marrjes së njoftimit për refuzimin/ kundërshtimin e shkatërrimit të mallrave nga mbajtësi/tregtari i mallrave, ISHMT-ja i mban mallrat të bllokuara deri në momentin e marrjes së një vendimi të formës së prerë nga gjykata për këto mallra.

20.5 Në rast se kërkuesi nuk depoziton kërkesë-padinë për shkelje të të drejtave në gjykatën kompetente ose nuk paraqet njëkohësisht kopjen e kërkesë-padisë në fjalë pranë ISHMT-së brenda 20 (njëzet) ditëve punë nga data e marrjes së njoftimit për refuzimin/kundërshtimin e shkatërrimit të mallrave nga mbajtësi/tregtari i mallrave, ISHMT-ja bën shënimin përkatës në procesverbalin/inventarin e mbajtur për këtë qëllim dhe revokon automatikisht vendimin për bllokimin e përkohshëm të mallrave në fjalë.

Sqarim: *Në çdo rast, kostot e lidhura me shkatërrimin e mallrave cënuese janë në ngarkim të mbajtësit të të drejtave.*

Hapi VIII: Vendimmarrja e ISHMT-së

Grupi i inspektimit, , brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e inspektimit disponon me vendim përfundimtar, duke vendosur marrjen e masës:

- Dënim kryesor

Çdo veprim i kryer në kundërshtim me përcaktimet e neneve 36, 127, 156 e 178, të ligjit nr. 9947/2008, "Për Pronësinë Industriale", të ndryshuar, për shkelje të të drejtave të pronësisë industriale, kur nuk përbën vepër penale, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me dënim kryesor me gjobë nga 100 000 deri në 500 000 lekë.

Sqarim: *Grupi i inspektimit përveç masës së bllokimit dhe/ose shkatërrimit aplikon dhe masën administrative me gjobë, sipas nenit 199, të ligjit për pronësinë industriale.*
Vendimmarrja lidhur me masën e gjobës, bazohet në parimin e proporcionaliotetit dhe metodologjisë së vendosjes së masave administrative.

Hapi IX: Njoftimi i vendimit të marrë nga ISHMT-ja

Vendimi i marrë nga ISHMT-ja i komunikohetbrenda 5 (pesë) ditëve pune:

- Mbajtësit/tregtarit të mallrave.

Hapi X: Arkivimi i procedurës së inspektimit

Për çdo procedurë inspektimi përgatitet një dosje e veçantë për evidentimin e punës gjatë procesit të inspektimit në portalin unik "e-inspektimi" dhe në zyrën e protokoll-arkivës së institucionit.

Dosjet e inspektimit duhet të regjistrojnë:

- Kërkësë ankësën kur inspektimi është në bazë kërkesë ankese;
- Njoftimet dhe dokumentat e administruara;
- Relacionin shpjegues për legjitimin e inspektimit kur bazohet në kërkesë ankesë;
- Autorizimine inspektimit;
- Procesverbalin e inspektimit;
- Foto. Foto te mostrave, mostra të marra;
- Listën e verifikimit dhe të tjera dokumente standard sipas rastit;
- Dokumentet mbështetëse të paraqitura nga subjekti i inspektimit;
- porcesverbale dhe vendime në lidhje me porcedurat e bllokimit, marrjes së mostrave apo të zhbllokimit të arsyetuara;
- Vendimin përfundimtar;
- Rezultatet e punës (plotësimi i nivelit të riskut).

Në përfundim, arkivimi bëhet në përputhje me parashikimet e ligjit për arkivat.

Sqarim: *Lidhur me të dhënat konfidenciale dhe "sekretin tregtar" duhet të zbatohen dispozitat e pjesës II/a "Sekretet tregtare", të ligjit nr. 9947/2008, "Për pronësinë Industriale" dhe përdorimi i tyre bëhet në bazë dhe brenda kufijve të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të dhënave që lidhen me veprimtarinë tregtare apo profesionale të subjektit.*
Gjithashtu, lidhur me administrimin e të dhënave personale, Inspektori do ti referohet urdherit 26, date 07.03.2017 të IQ "Për miratimin e rregullores "Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale gjatë procesit on-line të inspektimit", per Inspektoriatet qendrore dhe vendore në RSH"

Inspektimi ex-officio/ kryesisht

ISHMT-ja mund të ndërmarrë veprime *ex-officio* në tregun e brendshëm. Sipas programeve të inspektimit, të miratuara, ISHMT ndërmerr veprimet, si më poshtë:

Hapi I: Nxjerrja e autorizimit të inspektimit

1. Veprimet procedurale:

1.1 Propozimi i inspektimit: Drejtoria përgjegjëse, sipas planit të vlerësimit të riskut propozon pranë Kyenspektorit nxjerrjen e autorizimit të inspektimit.

1.2 Miratimi i autorizimit nga Kryeinspektori: Kryeinspektori miraton autorizimin për inspektimin, në të cilin përcaktohen të paktën, këto elemente:

a) inspektorati shtetëror apo vendor përkatës, që lëshon autorizimin;
b) objekti i inspektimit;
c) baza ligjore;
ç) data dhe vendi i lëshimit;
d) identiteti i inspektorit apo i inspektorëve të autorizuar për të kryer inspektimin;
dh) identiteti i personave të tjerë të autorizuar për kryerjen e veprimeve ndihmëse;
e) emri apo emërtimi dhe adresa e subjektit të inspektimit, të dhëna për përcaktimin sa më të qartë të tij, në rastin e inspektimit rastësor, apo të dhëna për përcaktimin sa më të saktë të veprimtarisë konkrete që i nënshtrohet inspektimit, në rast se emri, emërtimi dhe adresa nuk janë të njohura;
ë) kohëzgjatja në ditë për kryerjen e inspektimit;
f) vendi apo vendet ku do të kryhet inspektimi;
g) të dhënat e identifikimit, pozicioni dhe nënshkrimi i personit që ka lëshuar autorizimin.

Hapi II: Njoftimi paraprak i autorizimit

2. Përveç se në rastet kur:

a) ekziston rreziku që njoftimi mund të pengojë kryerjen me efektivitet të inspektimit;
b) mosnjoftimi përcaktohet shprehimisht nga ligji i posaçëm;
c) vijohet me inspektimin për verifikimin e korrigjimit të shkeljeve në përfundim të afatit të përcaktuar nga Grupi i Inspektimit;

d) periudha dhe objekti i inspektimit përcaktohet me akt të KM-së;
e) inspektimi është rastësor,
inspektimi i njoftohet nëpërmjet njoftimit paraprak të autorizimit subjektit të inspektimit jo më vonë se 3 ditë përpara fillimit të veprimeve të inspektimit.

Sqarim: *Për përllogaritjen e afatit të mbahet në konsideratë rregullat e përcaktuara në Kodin e Procedurave Administrative, sipas të cilave kur afati caktohet në ditë, në llogaritjen e tij përjashtohet dita kur ka ndodhur ngjarja, nga e cila fillon të ecë afati, si dhe të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj.*

Hapi III: Procedura e Inspektimit

3. Verifikimi pranë subjektit dhe barra e provës

3.1 Grupi i inspektimit paraqitet pranë subjektit, duke bërë me dije fillimisht:

a) Prezantimin dhe paraqitjen e kartës së inspektorit[20], shoqëruar me dokument identifikimi. Inspektori, gjatë gjithë kohës së inspektimit mban në një vend të dukshëm "K*artën e Inspektorit*" të lëshuar nga Inspektorati Qendror;
b) Autorizimin dhe arsyen e inspektimit;
c) I bën me dije subjektit procedurën e inspektimit;
d) I komunikon subjektit të inspektimit të drejtat dhe detyrat, si dhe pasojat e moszbatimit të tyre.

3.2 Pas prezantimit, grupi i inspektimit kërkon fillimisht nga subjekti shpjegime dhe dokumente për origjinën e mallrave, për të provuar e vërtetuar se mallrat në fjalë janë origjinale.

3.3 Në rast se dokumentacioni i vënë në dispozicion vlerësohet nga grupi i punës si i paplotë, kërkon nga mbajtësi/tregtari i mallrave të paraqesë shpjegimet dhe dokumentet mbështetëse shtesë brenda 5 (pesë) ditëve punë, pranë ISHMT-së. Barra e provës në këtë rast i takon mbajtësit/tregtarit të mallrave.

3.4 Nëse mbajtësi/tregtari i mallrave nuk jep shpjegime, dhe grupi i inspektimit vlerëson se, ka rrezik që malli të zhduket ose të vështirësohet, ose bëhet e pamundur marrja e tij, vendos masën e bllokimit të përkohshëm të mallrave që dyshohet se shkelin një të drejtë të pronësisë industriale.

4. Verifikimi i mallrave nga grupi i inspektimit

4.1 Grupi i inspektimit, verifikon, sipas rastit:

a) Për mallra të falsifikuara:
i. verifikimin nëse mallrat mallra, të cilat janë objekt i një veprimi që shkel një markë tregtare dhe, pa lejen e mbajtësit të së drejtës, mbajnë një shenjë

[20] Kartën e miratuar nga Inspektorati Qëndror.

identike me markën tregtare të regjistruar rregullisht për të njëjtat lloje mallrash ose që në thelb është e padallueshme nga kjo markë;

ii. mallra, të cilat janë objekt i një veprimi që shkel një tregues gjeografik/emërtim origjine dhe mbajnë ose janë të përshkruara me një emër ose term të mbrojtur lidhur me atë tregues gjeografik/emërtim origjine;

iii. çdo paketim, etiketë, ngjitës, broshurë, udhëzues përdorimi, dokument garancie ose artikull tjetër i ngjashëm, edhe nëse paraqitet veçmas, që është objekt i një veprimi që shkel një markë tregtare ose një tregues gjeografik/emërtim origjine, që përfshin një shenjë, emër ose term që është identik me një markë tregtare të regjistruar rregullisht ose tregues gjeografik/emërtim origjine të mbrojtur, ose që në thelb është e padallueshme nga një markë tregtare apo tregues gjeografik/emërtim origjine i tillë dhe që mund të përdoret për të njëjtin lloj mallrash si ai për të cilin është regjistruar marka tregtare ose treguesi gjeografik/emërtim origjine.

b) Për mallra pirate:

i. mallra, të cilat janë objekt i një veprimi që shkel të drejtat e një disenjoje industriale në Republikën e Shqipërisë dhe janë/ose përmbajnë kopje të bëra pa pëlqimin e mbajtësit të të drejtave të lidhur me disenjon industriale apo të një personi të autorizuar prej mbajtësit në vendin e prodhimit.

c) Për mallra që dyshohet se shkelin një të drejtë të pronësisë industriale, të cilat janë mallra të identifikuara në Republikën e Shqipërisë, të cilat, në pamje të parë, kanë tregues të arsyeshëm se:

i. janë objekt i një veprimi që shkel një të drejtë të pronësisë industriale në Republikën e Shqipërisë;

ii. kanë pajisje, produkte apo komponentë që janë projektuar, prodhuar ose përshtatur, kryesisht me qëllim për të mundësuar apo lehtësuar shmangien nga çdo teknologji, pajisje apo komponent, që në rrjedhën normale të operacionit të tij parandalon ose kufizon veprime lidhur me vepra të paautorizuara nga mbajtësi i të drejtave të pronësisë industriale dhe që lidhet me një veprim që shkel këto të drejta në Republikën e Shqipërisë;

iii. kanë çdo format apo matricë të disenjuar apo të përshtatur specifikisht për prodhimin e mallrave që shkelin të drejtën e pronësisë industriale, nëse këto formate apo matrica lidhen me një veprim që shkel të drejtën e pronësisë industriale në Republikën e Shqipërisë.

4.2 Verifikimi i ekzistencës të të drejtave të pronësisë industriale nga ISHMT-ja, në çdo rast shoqërohet me detyrimin për të kërkuar informacion pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale (DPPI) për ekzistencën e të drejtave të pronësisë industriale në Republikën e Shqipërisë, mbajtësit e regjistruar të të drejtave dhe përfaqësuesit të tyre në vendin tonë.

4.3 ISHMT-ja mund të kërkojë gjithashtu informacione shtesë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave (DPD) lidhur me mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale në doganë dhe ekzistencën e kërkesave për veprim pranë autoriteteve

doganore. Pas paraqitjes së kërkesës e ISHMT-së, DPPI-ja dhe DPD-ja sigurojnë, brenda afateve ligjore përkatëse të gjithë informacionin e nevojshëm nën administrimin e tyre:

a) për ekzistencën e të drejtave të pronësisë industriale
b) mbajtësve të regjistruar të të drejtave të tilla apo përfaqësuesve të tyre në Republikën e Shqipërisë,
c) si dhe çdo të dhënë tjetër lidhur me mallrat origjinale apo mallrat që dyshohet se shkelin një të drejtë të pronësisë intelektuale.

4.4 Nëse, grupi i inspektimit dyshon se, mallrat shkelin një të drejtë të pronësisë industriale, vendosin bllokimin e përkohshëm tëmallrave, shoqëruar me inventarizimin e saktë të tyre, dhe materiale fotografike dhe/ose video regjistrime, mostra.

4.5 Në përfundim tëverifikimeve, grupi i inspektimit dokumenton të gjithë veprimet e kryera, si dhe dokumentacionin e administruar, në kuadër të hetimit administrativ, dhe bën pasqyrim të plotë në procesverbal.

4.6 ISHMT, i komunikon subjektit të përfshirë në procedurën administrative, veprimin administrativ ose veprimin procedural, duke i vënë në dispozicion aktin përkatës (procesverbal/inventor).

5. Dokumentimi i gjithë veprimeve të kryera gjatë hetimit administrativ

5.1 Grupi i inspektimit:

a) Plotëson listë-verifikimin e miratuar nga Inspektorati Qendror. Listë-verifikimi, përcakton në mënyrë të menjëhershme gjetjet në subjekt, dhe shoqerohet me foto të çastit për gjendjen e subjektit;
b) Dokumenton të gjitha veprimet e ndërmarra në procesverbal/inventar, i cili nënshkruhet nga grupi i inspektimit përgjegjës dhe regjistrohet në regjistrin elektronik të institucionit. Në procesverbal pasqyrohen të gjitha veprimet e kryera nga grupi i inspektimit, dokumentacioni i verifikuar dhe detyrat e lëna lidhur me dokumentacionin dhe/ose shpjegimet shtesë të kërkuara, si dhe afatin e akorduar për plotësimin e tyre.

5.2 Kohëzgjatja e inspektimit fillon me hyrjen e inspektorit në mjediset, objektet, ku ushtron veprimtarinë subjekti i inspektimit. Kjo shënon edhe fillimin e "Procesverbalit të inspektimit" dhe plotësimin e menjëhershëm të list verifikimit.

5.3 Data e mbylljes së procesverbalit presupozon përfundimin e afatit të qëndrimit në subjektin që inspektohet, në rastet kur procesverbali ka mundësi të përfundohet në subjekt. Në rastet e tjera procesverbali mbyllet në ambientet e punës së grupit të inspektimit, dhe i komunikohet subjektit brenda 5 (pesë) ditëve.

6. Njoftimi i mbajtësit të së drejtës ose përfaqësuesit të autorizuar

6.1 Njoftimi bëhet në një nga adresat e poshtë cituara:

- vendbanimin ose vendqëndrimin e marrësit;

- çdo vend, ku marrësi ndodhet, përfshirë dhe institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale;
- selinë ose çdo vend ku ushtron veprimtarinë marrësi, nëse ky i fundit është person juridik;
- vendin e punës;
- vendin e ushtrimit të veprimtarisë ose zyrën e marrësit;
- çdo vend tjetër i specifikuar dhe i njoftuar paraprakisht nga pala.

6.2 Mbajtësi/tregtari i mallrave cenuese nënshkruan një deklaratë me anë të së cilës ai pranon shkatërrimin e mallrave në përdorim/posedim brenda 5 (pesë) ditëve punë nga data e njoftimit të vendimit të ISHMT-së.

6.3 Kur mbajtësi/tregtari i mallrave cenuese nuk ka dhënë me shkrim pëlqimin e tij për shkatërrimin e mallrave dhe as nuk ka kundërshtuar vendimin e shkatërrimit të këtyre mallrave brenda 5 (pesë) ditëve punë nga data e njoftimit të vendimit, ISHMT-ja prezumon se mbajtësi/tregtari i mallrave ka dhënë pëlqimin për shkatërrimin e mallrave.

6.4 Në rast se mbajtësi/tregtari i mallrave kundërshton bllokimin e mallrave dhe demonstron apo provon ligjërisht nëpërmjet dokumenteve përkatëse se mallrat nën posedimin/përdorimin e tij janë origjinale, ISHMT-ja revokon vendimin për bllokimin e përkohshëm të mallrave dhe njofton menjëherë kërkuesin brenda 3 (tri) ditësh nga data e marrjes së vendimit të revokimit.

6.5 Shkatërrimi i mallrave organizohet nën mbikëqyrjen e ISHMT-së jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike nga data e marrjes së vendimit të shkatërrimit. Kostot e lidhura me shkatërrimin e mallrave cënuese janë në ngarkim të kërkuesit.

7. Marrja e vendimit të ndërmjetëm

7.1 ISHMT, në cilësinë e strukturës kompetente për marrjen e vendimit përfundimtar, mund të marrë edhe vendime të ndërmjetme duke vendosur bllokimin e përkohshëm, kur gjykohet se mosmarrja e kësaj mase do të shkaktonte një dëm të rëndë e të pariparueshëm mbi interesin publik, apo të drejtave ose interesave të ligjshëm të palëve.

7.2 Bllokimi i përkohshëm mund të merret:

- me nismën e ISHMT-së, ose
- me kërkesën e palëve të interesuara.

Sqarim: *Vendimi i ndërmjetëm është me ekzekutim të menjëhershëm dhe mund të merret deri në çastin e marrjes së vendimit përfundimtar.*

8. Rastet e disponimit me vendim të ndërmjetëm

8.1 Gjatë procesit të inspektimit, grupi i inspektimit, me vendim të ndërmjetëm vendos masën e bllokimit të përkohshëm të tregtimit deri në eliminimin e rrezikut, kur:

a) vlerësohet se produkti paraqet një rrezik të çfarëdo kategorie, duke mos qenë në përputhje me kërkesat përkatëse të sigurisë;
b) megjithëse produkti është në përputhje kërkesat përkatëse të sigurisë, është i rrezikshëm dhe mund të rrezikojë sigurinë e jetës, shëndetit, mjedisit ose interesave të tjera publike,
c) rreziku mund të shmanget, brenda një afati të arsyeshëm, nëpërmjet modifikimit të produktit.

8.2 Grupi i inspektimit, kur konstaton 1 (një) ose disa nga rastet e cituara në pikën 8.1, të këtij Kapitulli, sipërcituar, vendos:

a) Bllokimin e përkohshëm të mallrave që dyshohet se shkelin një të drejtë të pronësisë industrial;

ose

b) Heqjen e mallrave që dyshohet se shkelin një të drejtë të pronësisë industrial përkohësisht nga tregu.

9. Ana formale e vendimit të ndërmjetëm

Vendimi për marrjen e masës së ndërmjetme duhet:

a) Të jetë arsyetuar;
b) Të jetë me afat të përcaktuar;
c) Të parashikojë detyrimin për njoftimin e palëve;
d) Të parashikojë të drejtën e palëve për ankim dhe afatin e ankimit.

10. Ekzekutimi i vendimit të ndërmjetëm

10.1 Masa e bllokimit të përkohshëm i komunikohet subjektit të inspektimit nga grupi i inspektimit paraprakisht, në mënyrë verbale, duke i dhënë mundësinë për të paraqitur pa vonesë komentet dhe shpjegimet përkatëse.

10.2 Subjekti e inspektuar ka të drejtë të paraqesë kontestimet e tij për vlerësimin e provave të administruara, për rezultatet e hetimit dhe për vendimin që synohet të merret nga organi publik.

10.3 Grupi i inspektimit shqyrton dhe vlerëson provat e paraqitura nga subjekti, dhe në përfundim vendos për marrjen ose jo të masave të përkohshme. Në çdo rast, vendimmarrja i komunikohet subjektit të inspektimit.

10.4 Në rastin kur, grupi i inspektimit disponon me vendim të ndërmjetëm për marrjen e masës së përkohshme, vendimi i ndërmjetëm për marrjen e masës së bllokimit pasqyrohet në procesverbal dhe i njoftohet subjektit, pa vonesë, në mënyrë verbale. Një akt i shkruar me të njëjtën përmbajtje njoftohet brenda 24 orëve.

10.5 Nëse subjekti i inspektimit nuk ekzekuton vullnetarisht dhe pa vonesë, apo nëse ai bën të ditur ose nga rrethanat rezulton se nuk do ta ekzekutojë vendimin, vendimi

ekzekutohet menjëherë nga grupi i inspektimit me shpenzimet e subjektit të inspektimit, të cilat pasqyrohen në vendimin përfundimtar apo në një akt të veçantë.

10.6 Në rast se, grupi i inspektimit ka disponuar me vendim të ndërmjetëm për bllokimin e përkohshëm të mallrave që dyshohet se shkelin një të drejtë të pronësisë industrial, atëherë bllokimi i mallrave do të kryhet pranë ambienteve të subjektit, duke vendosur nxjerrjen e menjëhershme nga tregu dhe ndalimin e përkohshëm të tregtimit të tyre.

10.7 Grupi i inspektimit, harton e mban procesverbalin/inventarin përkatës për natyrën dhe sasinë e mallit të bllokuar, duke i bashkëlidhur edhe pamjet fotografike që dokumentojnë bllokimin. Inventari dhe pamjet fotografike bëhen pjesë e praktikës përkatëse në sistemin e-inspektimi.

10.8 Në rast se mbajtësi/tregtari i mallrave kundërshton bllokimin e mallrave dhe demonstron apo provon ligjërisht nëpërmjet dokumenteve përkatëse se mallrat nën posedimin/përdorimin e tij janë origjinale, ISHMT-ja, revokon vendimin për bllokimin e përkohshëm të mallrave.

10.9 Grupi i inspektimit pasqyron në procesverbal konstatimet, provat, dhe shpjegimet e palëve, dhe vendos revokimin e masës së përkohshme.ISHMT, njofton kërkuesin brenda 3 (tri) ditësh nga data e marrjes së vendimit të revokimit të masës së përkohshme.

11. Ankimimi kundër vendimit të ndërmjetëm

11.1 Kundër vendimit të masës së bllokimit, subjekti i interesuar ka të drejtën e ankimit të veçantë. Ankimi i vecantë kundër masës së bllokimit mund të paraqitet brenda 5 (pesë) ditëve nga data e njoftimit të vendimit të ndërmjetëm.

11.2 Ankimi shqyrtohet drejtpërdrejt nga Kryeinspektori, i cili brenda 6 (gjashtë) ditëve nga data e paraqitjes së ankimit, disponon me vendim për zgjidhjen e ankimit të vecantë.

11.3 Vendimmarrja e Kryeinspektorit i komunikohet subjektit të interesuar menjëherë.

12. Përfundimi i vendimit të ndërmjetëm

12.1 Vendimi i ndërmjetëm për bllokimin e përkohshëm përfundon automatikisht, me kalimin e afatit të parashikuar në të dhe, kur nuk është përcaktuar një afat i tillë, me:

a) njoftimin e revokimit të tij;
b) njoftimin e përfundimit të procedimit apo njoftimin e vendimit përfundimtar, që nuk konstaton shkelje të kërkesave ligjore;
c) skadimin e afatit për njoftimin e vendimit përfundimtar të inspektimit pa një vendim të tillë;
d) njoftimin e vendimit të zgjidhjes së ankimit ndaj vendimit përfundimtar të inspektimit në rastin kur është bërë ankim;
e) skadimin e afatit për paraqitjen e ankimit administrativ ndaj vendimit përfundimtar pa bërë ankim;
f) me urdhërimin shprehimisht me vendim gjyqësor.

12.2 Vendimi i ndërmjetëm përfundon kur shfuqizohet pasi gjatë procedurës bie shkaku i parashikuar në ligj ku është mbështetur marrja e masës së bllokimit apo ndalimit të tregtimit në treg të mallrave.

Masa e bllokimi merret sipas Formatit "Vendimi i ndërmjetëm për marrjen e masës të bllokimit ose ndalimit të vendosjes në treg[21]".

Hapi IV: Vijimi i procedurave administrative

Në përfundim të hetimit administrativ, ISHMT, vendos, sipas rastit:

- *Bllokimin përfundimtar dhe shkatërrimin e mallrave cënuese;*

Ose

- *Revokimin e masës së përkohshme, dhe lirimin e mallrave.*

13. Bllokimi përfundimtar dhe shkatërrimi i mallrave cënuese

13.1 Në përfundim të procedurave verifikuese përkatëse dhe të veprimeve të përcaktuara më sipër, ISHMT, vendos vijimin e procedurave për bllokimin përfundimtar dhe shkatërrimin e mallrave cënuese, në rast se:

a) Merr konfirmimin me shkrim nga mbajtësi i së drejtës;

dhe

b) Mbajtësi/tregtari i mallrave nuk kundërshton vendimin e shkatërrimit.

13.2Vendimi i marrë nga ISHMT-ja i njoftohet kërkuesit dhe mbajtësit të identifikuar të të drejtave dhe mbajtësit/tregtarit të mallrave, duke i komunikuar gjithashtu se, kostot e shkatërrimit janë në ngarkim të kërkuesit.

13.3 Brenda 5 (pesë) ditëve punë nga data e njoftimit të vendimit të ISHMT-së, mbajtësi/tregtari i mallrave cënuese nënshkruan një deklaratë me anë të së cilës ai pranon shkatërrimin e mallrave në përdorim/posedim.

13.4 Kur mbajtësi/tregtari i mallrave cënuese nuk ka dhënë me shkrim pëlqimin e tij për shkatërrimin e mallrave dhe as nuk ka kundërshtuar vendimin e shkatërrimit të këtyre, mallrave brenda 5 (pesë)ditëve punë nga data e njoftimit të vendimit, prezumohet se mbajtësi/tregtari i mallrave ka dhënë pëlqimin për shkatërrimin e mallrave.

13.5 Jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike nga marrja e vendimit të shkatërrimit, organizohet shkatërrimi i mallrave nën mbikëqyrjen e ISHMT-së.

Në çdo rast, kostot e lidhura me shkatërrimin e mallrave cënuese janë në ngarkim të mbajtësit të të drejtave.

[21] Formati i miratuar, Aneksi ""bashkëlidhur këtij Manuali.

14. **Revokimi i masës së përkohshme**

14.1 Në përfundim të procedurave verifikuese përkatëse dhe të veprimeve të përcaktuara më sipër, ISHMT, vendos revokimin e masës së përkohshme, kur:

a) Kërkuesi nuk depoziton kërkesë-padinë për shkelje të të drejtave në gjykatën kompetente ose nuk paraqet njëkohësisht kopjen e kërkesë-padisë në fjalë pranë ISHMT-së brenda 20 (njëzet) ditëve punë nga data e marrjes së njoftimit për refuzimin/kundërshtimin e shkatërrimit të mallrave nga mbajtësi/tregtari i mallrave Në këtë rast, vendimi i bllokimit revokohet automatikisht dhe nga grupi i inspektimit dhe bëhet shënimi përkatës në procesverbal.

b) Mbajtësi/tregtari i mallrave kundërshton bllokimin e mallrave dhe demonstron apo provon ligjërisht nëpërmjet dokumenteve përkatëse se mallrat nën posedimin/përdorimine tij janë origjinale. Vendimi i bllokimit revokohet automatikisht dhe nga grupi i inspektimit dhe bëhet shënimi përkatës në procesverbal.

14.2Vendimi i marrë nga ISHMT-ja i njoftohet mbajtësit të identifikuar të të drejtave dhe/ose, sipas rastit, mbajtësit/tregtarit të mallrave, brenda 3 (tri) ditësh nga data e marrjes së vendimit të revokimit të masës së përkohshme.

15. **Procesi i shkatërrimit**[22] të mallrave

15.1 Në rastin kur, ISHMT, disponon me vendim përfundimtar për shkatërrimin e mallrave, atëherë:

a) brenda 5 (pesë) ditëve punë nga data e njoftimit të vendimit të ISHMT-së, subjekti nënshkruan një deklaratë me anë të së cilës ai pranon shkatërrimin e mallrave në përdorim/posedim,

ose

b) shkatërrimi vijohet pa pëlqimin e shprehur të mbajtësit/tregtarittë mallrave cënuese. Kur subjekti i inspektuar nuk ka dhënë me shkrim pëlqimin e tij për shkatërrimin e mallrave dhe as nuk ka kundërshtuar vendimin e shkatërrimit të këtyre mallrave brenda 5 (pesë) ditëve punë nga data e njoftimit të vendimit, ISHMT-ja prezumon se, subjekti ka dhënë pëlqimin për shkatërrimin e mallrave/miratim i heshtur.

15.2 Kur mbajtësi/tregtari i mallrave refuzon dhe kundërshton shkatërrimin e mallrave të bllokuar brenda afatit 5 (pesë) ditor nga data e njoftimit të vendimit të ISHMT-së, kjo e fundit njofton menjëherë kërkuesin, duke i komunikuar qëndrimin e mbajtësit/tregtarit të mallrave.

15.3 Nëse mbajtësi/tregtari i mallrave refuzon dhe kundërshton shkatërrimin e mallrave të bllokuara brenda afatit 5 ditor të përcaktuar në pikën 15.2, ISHMT-ja njofton menjëherë kërkuesin. Kërkuesi brenda 20 (njëzet) ditëve punë nga data e marrjes së

[22] Shkatërrimi i mallrave organizohet nën mbikëqyrjen e ISHMT-së jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike nga data e marrjes së vendimit të shkatërrimit. Kostot e lidhura me shkatërrimin e mallrave cenuese janë në ngarkim të mbajtësit të të drejtave.

njoftimit të ISHMT-së duhet të fillojë procedimin gjyqësor për shkelje të të drejtave të pronësisë industriale pranë gjykatës kompetente.
Kërkuesi brenda 20 (njëzet) ditëve punë nga data e marrjes së njoftimit të ISHMT-së duhet të njoftojë, gjithashtu, ISHMT-në për ngritjen e padisë në gjykatë duke paraqitur një kopje të kërkesë-padisë përkatëse.

15.4 Në rast se kërkuesi depoziton kërkesë-padinë për shkelje të të drejtave në gjykatën kompetente dhe paraqet njëkohësisht kopjen e kërkesë-padisë në fjalë pranë ISHMT-së brenda 20 (njëzet) ditëve punë nga data e marrjes së njoftimit për refuzimin/kundërshtimin e shkatërrimit të mallrave nga mbajtësi/tregtari i mallrave, ISHMT-ja i mban mallrat të bllokuara deri në momentin e marrjes së një vendimi të formës së prerë nga gjykata për këto mallra.

15.5 Në rast se kërkuesi nuk depoziton kërkesë-padinë për shkelje të të drejtave në gjykatën kompetente ose nuk paraqet njëkohësisht kopjen e kërkesë-padisë në fjalë pranë ISHMT-së brenda 20 (njëzet) ditëve punë nga data e marrjes së njoftimit për refuzimin/kundërshtimin e shkatërrimit të mallrave nga mbajtësi/tregtari i mallrave, ISHMT-ja bën shënimin përkatës në procesverbalin/inventarin e mbajtur për këtë qëllim dhe revokon automatikisht vendimin për bllokimin e përkohshëm të mallrave në fjalë.

Hapi V: Vendimmarrja e ISHMT-së

16. Në përfundim të hetimit administrativ, grupi i inspekltimit, brenda 30 (tridhjetë) ditëve disponon me vendim përfundimtar. Grupi i inspektimi vendos marrjen e njërës apo më shumë nga masat, si më poshtë:
    a. Dënim kryesor

Hapi VI: Njoftimi i vendimit të marrë nga ISHMT-ja

17. Vendimi marrë nga ISHMT-ja i komunikohet brenda 5 (pesë) ditëve pune:
    - Mbajtësit të identifikuar të të drejtave (kur identifikohet), dhe
    - Mbajtësit/tregtarit të mallrave.

Hapi VII: Arkivimi i procedurës së inspektimit

18. Për çdo procedurë inspektimi përgatitet një dosje e veçantë për evidentimin e punës gjatë procesit të inspektimit në portalin unik “e-inspektimi”.

    Dosjet e inspektimit duhet të regjistrojnë:

    - Emrin e subjektit që inspektohet;

- Objekti/fushën që inspektohet;
- Periudhën që mbulon ky inspektim;
- Autorizimin;
- Procesverbalin e inspektimit;
- Listën e verifikimit dhe të tjera dokumente standard sipas rastit;
- Dokumentet mbështetëse;
- Detajet e punës që është bërë, për shembull, objektivat dhe metodat;
- Rezultatet e punës (plotësimi i nivelit të riskut).

Në përfundim, arkivimi bëhet në përputhje me parashikimet e ligjit për arkivat.

Hapi VIII: Verifikimi i plotësimit të mangësive të lëna subjektit të inspektuar

19. Në rast se eventualisht për subjektin e inspektimit janë lënë detyra/rekomandime dhe është programuar verifikimi i tyre brenda një periudhe kohore të përcaktuar, grupi i inspektimit, brenda afatit të caktuar, verifikon plotësimin mangësive të evidentuara gjatë procedurave të inspektimit nga ana e subjektit të inspektuar.

    Procedura e inspektimit të zbatimit të detyrave të lëna nga inspektimi i mëparshëm është shumë e rëndësishme pasi, nëse subjekti nuk do të zbatojë detyrat e lëna dhe t'i zbatojë në një mënyrë efektive, atëherë veprimtaria e tij nuk do të jetë në përputhshmëri me kërkesat ligjore dhe për këtë, moskorrigjimi i parregullsive brenda afatit të përcaktuar, përbën, veçmas, kundërvajtje administrative dhe dënimi kryesor, sipas ligjit.

    Subjekti i inspektimit është i detyruar të njoftojë për korrigjimin e shkeljeve brenda afatit të përcaktuar me vendimin përfundimtar të inspektimit të mëparshëm dhe, nëse është e nevojshme, të paraqesë edhe provat që vërtetojnë këtë fakt.

KAPITULLI IV

Unifikimi i procedurave të inspektimit për monitorimin e të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to

1. Qëllimi i inspektimit në fushën e të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to

1.1 ISHMT, ushtron kompetencat ligjore inspektuese për vlerësimin e përputhshmërisë së veprimtarisë së subjekteve me përcaktimet e parashikuara në ligjin nr. 35/2016, "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to". ISHMT është përgjegjëse për garantimin dhe mbrojtjen e krijuesit ose autorit/titullarit të të drejtave për një vepër origjinale që ai ka krijuar. Mbrojtja nëpërmjet inspektimit, realizohet në 2 (dy) aspekte kryesore të drejtash:

- Të drejtat ekonomike, të cilat përfshijnë të drejtat e riprodhimit, transmetimit, performancës publike, përshtatjes, përkthimit, recitimit ne publik, shfaqjes publike, shpërndarjes e kështu me radhë;

dhe

- Të drejtat morale, të cilat përfshijnë të drejtat e autorit për të kundërshtuar ndonjë shtrembërim, gjymtim apo modifikim/ndryshim tjetër që mund ti bëhet veprës së tij që mund të dëmtojë nderin apo reputacionin e tij.

1.2 Gjithashtu, inspektimi në fushën e pronësisë intelektuale, ka për qëllim garantimin dhe mbrojtjen e të drejtave që i përkasin interpretuesve, prodhuesve të fonogramit, dhe organizatave transmetuese në lidhje me interpretimet e tyre, fonogramet dhe transmetimet respektive.

2. Inicimi i procedurës së inpektimit

2.1 Procedura e inspektimit, si një procedurë administrative mund të fillojë nga ISHMT *ex officio/kryesisht*, në bazë të programit të miratuar nga titullari i institucionit ose nëpërmjet ankesës nga:

- Mbajtësit e ligjshëm të të drejtave të njohura e të garantuara në bazë të ligjit për të drejtat e autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to, kur kërkojnë respektimin e të drejtave të tyre nga çdo shkelës dhe ndërmjetës, shërbimet e të cilit janë përdorur nga një palë e tretë për shkeljen e të drejtave që gëzojnë;
- Individët që janë autorizuar nga mbajtësit e së drejtës për përdorimin e të drejtave

që mbrohen nga ligji nr. 35/2016, i ndryshuar, në përputhje me autorizimin që u është dhënë atyre për këtë qëllim;
- Organizatat profesioniste të mbrojtjes dhe shoqatat përfaqësuese, të cilat janë autorizuar për të përfaqësuar mbajtësit e të drejtave;
- Mbajtësit e së drejtës, kur ekziston një rrezik i dukshëm se një shkelje e të drejtave të autorit.

2.2 Përjashtimisht, një inspektim konkret mund të autorizohet jashtë programit të inspektimit në rastet të përcaktuara në ligjin e inspektimit ose kur parashikohet shprehimisht nga ligji i posaçëm. Ligji nr. 35/2016, ka parashikuar se në çdo rast kontrolli për mbrojtjen e të drejtave të autorit në tregun e brendshëm bëhet në përputhje me ligjin për inspektimin.

Sqarim: *Nëse ka disa mbajtës për të njëjtën të drejtë, sipas ligjit për të drejtat e autorit, secili prej tyre ka të drejtën e mbrojtjes së të drejtës së tij ndaj mbajtësve të tjerë.*

3. Objekti i kontrollit

3.1 Në çdo rast, objekti i kontrollit konsiston në:
- Produktin fizik;

dhe/ose

- Në kontrollin e lejes/autorizimit të lëshuar nga mbajtësit e të drejtave ose agjencitë e licencuara të administrimit kolektiv, sipas parashikimeve të ligjit për të drejtat e autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to, apo kontrollin e kontratave të posaçme.

3.2 Grupi i inspektimit, kontrollon:
a) Lejen/autorizimin e lëshuar nga ana e autorit për të zbuluar për herë të parë për publikun veprën ose përshkrimin e veprës së autorit apo përdorimin e saj pa përmendur autorësinë ose pa autorizim;
b) Shtrembërimin, modifikimin e një vepre ose përdorimin e veprës në një mënyrë që cënon nderin dhe reputacionin e autorit;
c) Riprodhimin e veprës së autorit pa autorizimin e autorit ose mbajtësit të së drejtës së autorit ose një AAK-je;
d) Shpërndarjen ose dhënien me qira apo ndërrmarrjen e akteve të tjera, për qëllime të shpërndarjes së veprës së autorit pa autorizimin e autorit ose mbajtësit të së drejtës së autorit ose një AAK-je;
e) Komunikimin në publik të një vepër të së drejtës së autorit në çfarëdo mënyre pa autorizimin e autorit ose mbajtësit të së drejtës së autorit ose një AAK-je;
f) Transformimin e një vepre të autorit pa autorizimin e autorit ose mbajtësit të së drejtës së autorit ose një AAK-je;
g) Shpërndarjen ose mbajtjen për qëllime tregtare një kopje të një programi kompjuterik, duke editur ose që ka mundësinë për ta verifikuar se është ekzemplar i paligjshëm ose çdo mjet, qëshmang masat teknologjike për mbrojtjen e një programi kompjuterik;

h) Mos evidentimin e emrit, pseudonimit ose ndonjë shenjë tjetër të një interpretuesi dhe/ose ekzekutuesi, përveç nëse ky i fundit ka deklaruar me shkrim se ai nuk dëshiron të përmendet ose kur përdor veprën e tij në publik ose pa autorizimin e një interpretuesi dhe/ose ekzekutuesi shtrembëron, modifikon shfaqjen ose përdor veprën në një mënyrë që cenon ose mund të shkelë nderin dhe reputacionin e interpretuesit dhe/ose ekzekutuesit;
i) Shkeljen e të drejtave të autorit dhe të drejtave ekskluzive pasurore të tyre pa autorizimin e interpretuesve dhe/ose ekzekutuesve ose AAK-së;
j) Shkeljen e të drejtave eksluzive pasurore pa autorizimin e prodhuesit të fonogrameve ose AAK-së;
k) Shkeljen e të drejtave në kundërshtim me ligjin lidhur me mungesën e autorizimit të prodhuesit të fiksimeve /regjistrimeve të para të filmave ose të një shpërndarësi të autorizuar ku prodhuesi ka transferuar të drejtat e tij;
l) Shkeljen e të drejtave eksluzive në rast të veprimit pa autorizimin e një organizate/ ofruesve të shërbimit mediatik;
m) Riprodhimim e fotokopjeve për përdorim privat ose përdorim tjetër personal pa autorizimin e botuesit dhe pa i paguar atij shpërblimin përkatës;
n) Përdorimin, nxjerrjen ose bërjen e disponueshme për publikun, përcjelljen në publik ose përdorimin në mënyrë të paligjshme të bazave të të dhënave pa autorizimin e krijuesit të bazës së të dhënave;
o) Shmangjen e masave teknologjike për mbrojtjen e së drejtës së autorit dhe të drejtave të lidhura me të;
p) Heqjen ose ndryshimin e informacionit elektronik të administrimit të të drejtave të autorit dhe të drejtave të lidhura me to.

4. Procedurat e inspektimit

Inspektimi ex officio/kryesisht

Hapi I: Nxjerrja e autorizimit të inspektimit

1. **Veprimet procedurale:**
   1.1 Propozimi i inspektimit: Drejtoria përgjegjëse, sipas planit të vlerësimit të riskut propozon pranë Kyenspektorit nxjerrjen e autorizimit të inspektimit.
   1.2 Miratimi i autorizimit nga Kryeinspektori: Kryeinspektori miraton autorizimin për inspektimin, në të cilin përcaktohen të paktën, këto elemente:
   a) inspektorati shtetëror apo vendor përkatës, që lëshon autorizimin;
   b) objekti i inspektimit;
   c) baza ligjore;
   ç) data dhe vendi i lëshimit;
   d) identiteti i inspektorëve të autorizuar për të kryer inspektimin;
   dh) identiteti i personave të tjerë të autorizuar për kryerjen e veprimeve ndihmëse;

e) emri apo emërtimi dhe adresa e subjektit të inspektimit, të dhëna për përcaktimin sa më të qartë të tij, në rastin e inspektimit rastësor, apo të dhëna për përcaktimin sa më të saktë të veprimtarisë konkrete që i nënshtrohet inspektimit, në rast se emri, emërtimi dhe adresa nuk janë të njohura;
ë) kohëzgjatja në ditë për kryerjen e inspektimit;
f) vendi apo vendet ku do të kryhet inspektimi;
g) të dhënat e identifikimit, pozicioni dhe nënshkrimi i personit që ka lëshuar autorizimin.

Hapi II: Njoftimi paraprak i autorizimit

2. Grupi i inspektimit kryen njoftim paraprak të autorizimit për subjektin e inspektimit jo më vonë se 3 ditë përpara fillimit të veprimeve të inspektimit.
3. Pavarësisht nga njoftimi paraprak i autorizimit, në çdo rast, inspektori shtetëror, përpara fillimit të veprimeve të inspektimit, informon, verbalisht, përfaqësuesin e subjektit të inspektimit për:
   - objektin e inspektimit;
   - të drejtat e detyrimet e subjektit të inspektimit, sipas ligjit;
   - pasojat ligjore të mosrespektimit të këtyre detyrimeve;
   - metodën e inspektimit e afatet për përfundimin e inspektimit.
4. Në raste të veçanta, kur e parashikon ligji specifik, grupi i inspektimit mund të mos e njoftojë paraprakisht subjektin që inspektohet. Këto raste të veçanta bazohen tek legjislacioni specifik i fushës përkatëse të inspektimit dhe kryesisht lidhen me inspektime me natyrë të veçantë, si p.sh. kur mund të ketë të dhëna për zhdukje të fakteve nga subjekti i inspektimit. Në këto rrethana, njoftimi paraprak për inspektim mund të sjellë që subjekti të fshehë informacion të rëndësishëm për inspektorët shtetërorë.
5. Njoftimi paraprak nuk kryhet në rastet e parashikuara nga ligji i inspektimit, të cilat duhet të evidentohen dhe janë si më poshtë:
   - kur ekziston rreziku që njoftimi mund të pengojë kryerjen me efektivitet të inspektimit;
   - kur mosnjoftimi përcaktohet shprehimisht nga ligji i posaçëm;
   - për inspektimin për verifikimin e korrigjimit të shkeljeve në përfundim të afatit të përcaktuar;
   - konstatohet në flagrancë nga inspektori shkelja e një kërkese ligjore, brenda fushës së tij të inspektimit;
   - për inspektimin rastësor.
6. Në çdo rast të inspektimit pa njoftim paraprak, Kryeinspektori është i detyruar të përfshijë në autorizimin e inspektimit, motivimin, përse nuk do të bëhët njoftimi paraprak i subjektit.

Hapi III: Hetimi administrativ

7. Verifikimi pranë subjektit dhe barra e provës

7.1 Grupi i inspektimit paraqitet pranë subjektit, duke bërë me dije fillimisht:
   a) Prezantimin dhe paraqitjen e kartës së inspektorit[23], shoqëruar me dokument identifikimi;
   b) Autorizimin dhe arsyen e inspektimit.

7.2 Pas prezantimit, grupi i inspektimit kërkon fillimisht nga subjekti shpjegime dhe dokumente si: leje/autorizim dhe/ose kontratë për shfrytëzimin e veprës.

7.3 Në rast se dokumentacioni i vënë në dispozicion vleresohet nga grupi i punës si i paplotë, kërkon nga mbajtësi/tregtari i mallrave të paraqesë shpjegimet dhe dokumentet mbështetëse shtesë brenda 5 (pesë) ditëve punë, pranë ISHMT-së. Barra e provës në këtë rast i takon shfrytëzuesit/përdoruesit të të drejave të autorit dhe të drejtave të lidhura me to.

7.4 Grupi i inspektimit plotëson listën e verifikimeve, sipas formatit të miratuar.

7.5 Grupi i inspektimit dokumenton të gjitha veprimet e ndërmarra në procesverbal/ inventar, i cili nënshkruhet nga grupi i inspektimit përgjegjës dhe regjistrohet në regjistrin elektronik të institucionit. Në procesverbal pasqyrohen të gjitha veprimet e kryera nga grupi i inspektimit, dokumentacioni i verifikuar, pamjet fotografike dhe detyrat e lëna lidhur me dokumentacionin dhe/ose shpjegimet shtesë të kërkuara, si dhe afatin e akorduar për plotësimin e tyre.

8. Verifikimi dhe marrja e provave

8.1 Grupi i inspektimit bën vlerësimin e provave sipas bindjes, se cilat fakte konsiderohen të provuara, bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veçmas dhe të gjitha provave së bashku, si dhe në rezultatin tërësor të hetimit administrativ.

8.2 Nëse, grupi i inspektimit dyshon se, shkelen të drejtat e autorit apo të drejtat e lidhura me to, vendos bllokimin e objekteve, që mbrohen nga të drejtat e autorit dhe të drejtat e lidhura me to, inventarizimin e saktë të tyre, materiale fotografike dhe/ose video regjistrime tëveprës/ave, shoqëruar me inventarizimin e saktë të tyre, dhe materiale fotografike dhe/ose video regjistrime. Në përfundim të hetimit, grupi i inspektimit dokumenton të gjithë veprimet e kryera, si dhe dokumentacionin e administruar, në kuadër të hetimit administrativ, dhe bën pasqyrim të plotë në procesverbal.

9. Njoftimi i autorit të veprës/ titullarit të të drejtave të veprës origjinale, dhe/ose subjektit ankues

9.1 ISHMT, njofton subjektin e inspektimit lidhur me marrjen e vendimit të ndërmjetëm për bllokimin e veprës/ave, që mbrohen nga të drejtat e autorit dhe të drejtat e

[23] *Kartën e miratuar nga Inspektorati Qëndror.*

lidhura me to. Njoftimi i ISHMT-së, sipas formatit të miratuar, përfshin, duke mos u kufizuar në: natyrën dhe sasinë reale ose të vlerësuar të objekteve, pamje fotografike, mostra apo riprodhime të mallrave etj.

9.2 Njoftimi bëhet në një nga adresat e poshtë cituara të autorit të veprës/ titullarit të të drejtave të veprës origjinale, dhe/ose subjektit ankues:

- vendbanimin ose vendqëndrimin;
- çdo vend, ku subjekti i njoftimit ndodhet, përfshirë dhe institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale;
- selinë ose çdo vend ku ushtron veprimtarinë subjekti i njoftimit, nëse ky i fundit është person juridik.

Hapi IV: Vijimi i procedurave administrative

10. Grupi i inspektimit, verifikon, sipas rastit:

10.1Lejen/autorizimin e lëshuar nga ana e autorit ose mbajtësit të së drejtës së autorit, ose një AAK-je për:

i. të zbuluar për herë të parë për publikun veprën ose përshkrimin e veprës së autorit apo përdorimin e saj;
ii. riprodhimin e veprës së autorit pa autorizimin e autorit;
iii. shpërndarjen ose dhënien me qira apo ndërrmarrjen e akteve të tjera, për qëllime të shpërndarjes së veprës së autorit;
iv. komunikimin në publik të një vepër të së drejtës së autorit në çfarëdo mënyre;
v. transformimin e një vepre të autorit.

10.2 Lejen/autorizimin e:

i. prodhuesit të fonogrameve, të prodhuesit të fiksimeve /regjistrimeve të para të filmave ose të një shpërndarësi të autorizuar ku prodhuesi ka transferuar të drejtat e tij;
ii. të drejtave eksluzive të shërbimit mediatik;
iii. botuesit për riprodhimin e fotokopjeve për përdorim privat ose përdorim tjetër personal;
iv. interpretuesve dhe/ose ekzekutuesve ose AAK-së të të drejtave të autorit dhe të drejtat ekskluzive pasurore të tyre;
v. të drejtave eksluzive pasurore;
vi. krijuesit të bazës së të dhënave për përdorimin, nxjerrjen ose bërjen e disponueshme për publikun, përcjellja në publik ose përdorimi i bazave të të dhënave.

10.3 Elementet eventuale mbi:

i. Shtrembërimin, modifikimin e një vepre ose përdorimin e veprës në një mënyrë që cënon nderin dhe reputacionin e autorit;
ii. Shpërndarjen ose mbajtjen për qëllime tregtare një kopje të një programi kompjuterik, duke e ditur ose që ka mundësinë për ta verifikuar se është ekzemplar i paligjshëm ose çdo mjet, shmang masat teknologjike për mbrojtjen

e një programi kompjuterik;

iii. Mos evidentimime emrit, pseudonimit ose ndonjë shenjë tjetër të një interpretuesi dhe/oseekzekutuesi, përveç nëse ky i fundit ka deklaruar me shkrim se ai nuk dëshiron të përmendet ose kur përdor veprën e tij në publik;

iv. Shmangien e masave teknologjike për mbrojtjen e së drejtës së autorit dhe të drejtave të lidhura me të;

v. Heqjen ose ndryshimine informacionit elektronik të administrimit të të drejtave të autorit dhe të drejtave të lidhura me to.

11. Masat e ndërmjetme

11.1 Grupi i inspektimit, ka të drejtë të vendosë masa të ndërmjetme ndaj një personi juridik ose personi fizik, që kryen kundërvajtje.

11.2 Sipas parashikimeve në ligjin nr. 35/2016, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij tregtare, mund të ndërmerret masa e ndalimit të kryerjes së aktiviteteve të tij tregtare, për shkeljen e së drejtës së autorit ose të drejtave të lidhura me të, për një periudhë prej 1 (një) viti, duke marrë parasysh seriozitetin e shkeljeve dhe përsëritjen e këtyre shkeljeve nga ana e tyre

12. Ana formale e vendimit të ndërmjetëm

Vendimi për marrjen e masave të ndërmjetme duhet:

a) Të jetë arsyetuar;
b) Të jetë me afat të përcaktuar;
c) Të parashikojë detyrimin për njoftimin e palëve;
d) Të parashikojë të drejtën e palëve për ankim dhe afatin e ankimit.

Hapi V: Njoftimi i vendimit të ISHMT

13. Vendimi i marrë nga ISHMT-ja i njoftohet:

- Mbajtësit të identifikuar të të drejtave (kur identifikohet)

dhe

- Subjektit të inspektuar.

14. Ankimimi kundër vendimit të ndërmjetëm

14.1 Kundër vendimit të masës së bllokimit, subjekti i interesuar ka të drejtën e ankimit të veçantë. Ankimi i vecantë kundër masës së bllokimit mund të paraqitet brenda 5 (pesë) ditëve nga data e njoftimit të vendimit të ndërmjetëm.

14.2 Ankimi shqyrtohet drejtpërdrejt nga Kryeinspektori, i cili brenda 6 (gjashtë) ditëve nga data e paraqitjes së ankimit, disponon me vendim për zgjidhjen e ankimit të vecantë.

14.3Vendimmarrja e Kryeinspektorit i komunikohet subjektit të interesuar menjëherë.

15. Përfundimi i vendimit të ndërmjetëm

15.1 Vendimi i ndërmjetëm përfundon automatikisht, me kalimin e afatit të parashikuar në të dhe, kur nuk është përcaktuar një afat i tillë, me:

a) njoftimin e revokimit të tij;
b) njoftimin e përfundimit të procedimit apo njoftimin e vendimit përfundimtar, që nuk konstaton shkelje të kërkesave ligjore;
c) skadimin e afatit për njoftimin e vendimit përfundimtar të inspektimit pa një vendim të tillë;
d) njoftimin e vendimit të zgjidhjes së ankimit ndaj vendimit përfundimtar të inspektimit në rastin kur është bërë ankim;
e) skadimin e afatit për paraqitjen e ankimit administrativ ndaj vendimit përfundimtar pa bërë ankim;
f) me urdhërimin shprehimisht me vendim gjyqësor.

15.2 Vendimi i ndërmjetëm përfundon kur shfuqizohet pasi gjatë procedurës bie shkaku i parashikuar në ligj ku është mbështetur marrja e masës së bllokimit apo ndalimit të tregtimit në treg të mallrave.

Hapi VI: Vendimmarrja e ISHMT-së

16 Në përfundim të hetimit administrativ, grupi i inspektimit, disponon me vendim përfundimtar.

Sqarim: Lidhur me administrimin e të dhënave personale, Inspektori do t'i referohet Urdhrit 26, date 07.03.2017, të IQ, "Për miratimin e rregullores "Për mbrojtjen, përpunimin, eeuajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale gjatë procesit on-line të inspektimit", për Inspektoriatet qendrore dhe vendore në RSH" masat, si më poshtë:

- Dënimin kryesor me gjobë;
- Korrigjimi i shkeljeve të konstatuara dhe eliminimi i pasojave të tyre në një afat kohor të arsyeshëm;

  Grupi i inspektimit, në kuadër të korrigjimit të shkeljeve të konstatuara dhe eliminimin e pasojëve, këshillon me shkrim subjektin e inspektuar, duke përcaktuar:

- Shkeljen e konstatuar;
- Mënyrën e korrigjimit të shkeljes/ve;
- Afatin e korrigjimit.

Hapi VII: Njoftimi i vendimit të marrë nga ISHMT-ja

17 Vendimi marrë nga ISHMT-ja i komunikohet brenda 5 (pesë) ditëve pune:

- Mbajtësit të identifikuar të të drejtave (kur identifikohet),

dhe

- Subjektit të inspektuar.

Hapi VIII: Arkivimi i procedurës së inspektimit

18 Për çdo procedurë inspektimi përgatitet një dosje e veçantë për evidentimin e punës gjatë procesit të inspektimit në portalin unik "e-inspektimi".
Dosjet e inspektimit duhet të regjistrojnë:

- Emrin e subjektit që inspektohet;
- Objekti/fushën që inspektohet;
- Periudhën që mbulon ky inspektim;
- Autorizimin;
- Procesverbalin e inspektimit;
- Listën e verifikimit dhe të tjera dokumente standard sipas rastit;
- Dokumentet mbështetëse;
- Detajet e punës që është bërë, për shembull, objektivat dhe metodat;
- Rezultatet e punës (plotësimi i nivelit të riskut).

Në përfundim, arkivimi bëhet në përputhje me parashikimet e ligjit për arkivat.

Hapi IX: Verifikimi i plotësimit të mangësive të lëna subjektit

19 Grupi i inspektimit, brenda afatit të caktuar, verifikon plotësimin e mangësive të evidentuara gjatë procedurave të inspektimit nga ana e subjektit.

20 Subjekti i inspektimit është i detyruar të njoftojë për korrigjimin e shkeljeve brenda afatit të përcaktuar me vendimin përfundimtar të inspektimit të mëparshëm dhe, nëse është e nevojshme, të paraqesë edhe provat që vërtetojnë këtë fakt.

**Në rastin e inspektimit me ankesë-kërkesë, veprimet procedurale përpara nxjerrjes së autorizimit, zbatohen "mutatis mutandis" si në rastin i inspektimeve në fushën e pronësisë industriale, trajtuar më lart, duke verifikuar:*

- *Përmbajtjen e kërkesë-ankesës;*
- *Dokumentacion shoqërues[24];*
- *Trajtimin e kërkesë-ankesës dhe verifikimin e dokumentacionit shoqërues.*

Hapat procedurale aplikohen njësoj sipas kapitullit III, pika 1.1 "Inspektimi me ankesë-kërkesë".

[24] "Dokumentacioni paraqitet në kopje origjinale ose të njësuar me origjinalin. Të gjitha dokumentet duhet të jenë të përkthyera në gjuhën shqipe"

KAPITULLI V

Parime të përgjithshme të etikës

1. Legjislacioni zbatues

Veprimtaria e punonjësve të ISHMT-së,në kuadër të respektimit të etikës mbështetet, por pa u kufizuar, në:

- ✓ Kodin e Procedurave Administrative;
- ✓ Ligjin nr.9367, datë 7.4.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike"i ndryshuar;
- ✓ Kodin e Etikës.

Sqarim: *Lidhur me administrimin e të dhënave personale, Inspektori do t'i referohet urdherit 26, date 07.03.2017 të IQ "Për miratimin e rregullores "Për mbrojtjen, përpunimin,ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale gjatë procesit on-line të inspektimit", per Inspektoriatet qendrore dhe vendore në RSH dhe "Rregulloren "Për parandalimin e konfliktit të interesit në ISHMT"*

2. Parimet e etikës

Në kryerjen e funksionit të tij, çdo inspektor është i detyruar:

a) të respektojë dhe zbatojë me korrektësi ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi, urdhrat dhe udhëzimet e brendshme, duke dëshmuar në këtë mënyrë integritet të lartë moral dhe profesional, në funksion të plotë të ruajtjes së reputacionit dhe imazhit të institucionit;
b) të jetë objektiv, i pavarur, i paanshëm, i kujdesshëm në dhënien e mendimeve në mënyrë publike, mbi informacionin që zotëron, për shkak të funksionit që ushtron, kontrollues ose jo;
c) të jetë i ndershëm dhe i përkushtuar në kryerjen e detyrës së tij, duke pasur parasysh vetëm interesin publik;
d) të marrë masa të mbrojë pavarësinë e tij nga ndikime të brendshme apo të jashtme;
e) që në asnjë rast dhe për asnjë arsye, mos të pranojë udhëzime apo sugjerime lidhur me performancën e detyrave të tij zyrtare, nga asnjë burim tjetër, përveç institucionit ku ushtron funksionin e tij/saj;
f) që në çdo rast, mendimet, sugjerimet, propozimet, konkluzionet dhe vendimmarrjet, të jenë ngushtësisht të lidhura vetëm me qëllimin e funksionit që kryen punonjësi, dhe në asnjë rast në tejkalim të këtij qëllimi;
g) të respektojë dinjitetin e çdo personi, pa diskriminim dhe paragjykim ndaj përkatësisë etnike dhe kombësisë, përkatësisë shoqërore, pasurisë, moshës, paaftësisë fizike, besimit

fetar, gjinisë, pikëpamjeve politike, orientimit seksual apo çdo gjendje tjetër, e cila përbën shkak për paragjykime dhe trajtim të njëanshëm.

3. Shmangia dhe deklarimi i konfliktit të interesit

3.1 Në kryerjen e funksionit të tij, çdo inspektor është i detyruar të marrë masa konkrete, në përputhje me ligjin nr.9367, datë 07.04.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar dhe Kodin e Procedurave Administrative për parandalimin, shmangien dhe zgjidhjen e konfliktit të interesave në ushtrimin e detyrave të tij, konkretisht:

a) Në asnjë rast, mendimet, sugjerimet, propozimet, konkluzionet dhe vendimmarrja e inspektorit nuk duhet të jenë të paramenduara me qëllime përfitimi moral, profesional apo material, për vete apo për familjarët e tij.

b) Në asnjë rast, inspektori nuk duhet të pranojë apo të kërkojë, në mënyrë të drejtpërdrejt apo të tërthortë të mira materiale, dhurata, trajtime preferenciale, premtime, për vete apo për familjarët e tij, për shkak të funksionit që ai kryen.

c) Rastet e dhuratave protokollare duhet të raportohen menjëherë pranë eprorit direkt ose strukturës së burimeve njerëzore.

3.2 Në rast se inspektori konstaton që gjendet në kushtet e konfliktit të interesit, duhet të njoftojë eprorin, dhe më pas të vijojë me dorëheqje të arsyetuar, për gjendjen e konfliktit të interesit.

4. Ushtrimi i veprimtarive të jashtme të inspektorëve

Në çdo rast do të bëhet në përputhje me aktet nënligjore të dala në zbatim të rregullimit të fushës së veprimtarive të jashtme. Konkretisht:

- Në çdo rast, inspektoriduhet të ndjekë procedurën e përcaktuar në aktet nënligjore, dhe të marrë masa që kryerja e veprimtarive të jashtme të mos sjellë pengesa apo vonesa në kryerjen e funksionit që ai mbart;
- Në asnjë rast, kryerja e kësaj veprimtarie nuk duhet të cënojë reputacionin e institucionit, të cënojë pavarësinë, dinjitetin dhe integritetin moral dhe profesional të inspektorit.

5. Integriteti profesional i inspektorëve

Në ushtrimin e funksionit publik, në çdo rast inspektori:

a) Duhet të ruajë një nivel të lartë profesional;

b) Të bëjë kujdes që të jetë i azhornuar me praktikat e unifikuara të punës, me eksperiencën dhe praktikat më të mira të institucioneve homologe;

c) Të marrë pjesë në mënyrë aktive në kurse, seminare dhe aktivitete që synojnë rritjen e kapaciteteve profesionale.

6. Konfidencialiteti dhe ruajtja e informacionit

Në asnjë rast, për shkak të funksionit që kryen inspektori:

a) nuk duhet të përdorë apo keqpërdorë informacionin që disponon, në tejkalim të qëllimit për të cilin është vënë në dijeni;
b) nuk duhet t'i japë personave të tjerë brenda dhe jashtë institucionit, për asnjë arsye, informacionin që disponon, përveç rasteve kur autorizohet nga eprori;
c) nuk duhet të nxjerrë të dhënat personale të subjekteve për të cilat vihet në dijeni për shkak të funksionit që kryen dhe detyrohet të ruajë konfidencialitetin e këtyre të dhënave gjatë gjithë periudhës kohore që ushtron funksionin në institucion, por dhe më pas, në përputhje me përcaktimet e bëra në ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar.

7. Zbatimi i rregullave të etikës

7.1 Inspektori duhet:

- të tregojë integritet të lartë moral dhe korrektësi gjatë orarit zyrtar, por dhe përtej këtij orari;
- të jetë i përkushtuar në kryerjen e detyrave të tij funksionale, zbatimin me korrektësi të orarit zyrtar, përdorimin e mjeteve të punës posaçërisht në funksion të kryerjes së detyrave të tij, si dhe të marrë masa për një paraqitje etike në veshje. Paraqitja fizike duhet të vlerësohet me seriozitet maksimal nga vetë punonjësi, pasi influencon në krijimin e imazhit të institucionit që përfaqëson tek subjekti i inspektimit dhe publiku.

7.2 Në asnjë rast, pavarësisht ngarkesës në punë, inspektori nuk duhet të marrë dokumenta zyrtarë në shtëpi, ose jashtë ambienteve të zyrave.

7.3 Për një prezantim sa më dinjitoz personal dhe të institucionit që përfaqëson, inspektorit i ndalohen sjellje të papranueshme, të cilat cënojnë imazhin e tij, si:

a) konsumimi i pijeve alkoolike, të cilat ndikojnë në gjendjen mendore dhe emocionale, gjatë kryerjes së detyrës;
b) komunikimi me tone të larta;
c) mungesa e etikës në komunikim, etj.

8. Përgjegjësitë e inspektorit

Në zbatim të parimit të përgjegjshmërisë në punë dhe ruajtjes së etikës, gjatë ushtrimit të funksionit publik inspektorët:

✓ mbajnë përgjegjësi për dëmet që shkaktojnë nëpërmjet marrjes së vendimeve të paligjshme apo refuzimit të paligjshëm për të marrë vendime;
✓ duhet të jenë të kujdesshëm në përdorimin e mjeteve dhe pronës së institucionit dhe

nuk duhet të përdorin mjetet institucionale për qëllime personale apo për përdorim privat;

- ✓ duhet të evitojnë shpërdorimin dhe keqpërdorimin e burimeve dhe mjeteve të institucionit;
- ✓ duhet të kryejnë detyrën e tyre në mënyrë të drejtë, ndershmërisht dhe brenda kuadrit ligjor;
- ✓ duhet të jetë i komunikueshëm me kolegët, të tregojë respekt ndaj tyre, pavarësisht shkallës së hierarkisë, dhe të mos cenojë kolegët apo vartësit nga ana morale, etike dhe profesionale;
- ✓ duhet të bashkëpunojë me kolegët dhe vartësit, në funksion të kryerjes së detyrave funksionale, të japë informacion të plotë dhe të saktë kur i kërkohet, dhe në asnjë rast të mos diktojë dhe të mos ushtrojë presion në vendimmarrjet e kolegëve dhe të vartësve të tij;
- ✓ duhet të karakterizohet nga etika e komunikimit, brenda dhe jashtë ambienteve të zyrave;
- ✓ duhet të kenë një sjellje të mirë dhe të denjë në të gjitha rrethanat, me qëllim respektimin e moralit dhe drejtësisë gjatë ushtrimit të funksionit;
- ✓ duhet të paraqiten me veshje serioze, për të respektuar autoritetin institucional në marrëdhënie ndërmjet kolegëve dhe me subjektet e inspektimit;

9. Detyrimi për njoftim

9.1 Kur inspektori/ grupi i inspektimit, gjatë kryerjes së një inspektimi, ka dyshime të arsyeshme për shkeljen e kërkesave ligjore, që janë në kompetencën e një inspektorati tjetër shtetëror apo vendor, ai njofton me shkrim dhe pa vonesë Inspektoratin Qendror. Inspektorati Qendror, me marrjen e njoftimit, ia përcjell atë, pa vonesë, inspektoratit kompetent.

9.2 Kur shkeljet e konstatuara gjatë inspektimit janë kryer në mënyrë të tillë që cenojnë të drejtat apo interesat e ligjshëm të një personi të tretë, inspektorati njofton personin e tretë për këtë fakt, gjetjet e inspektimit dhe masat e marra.

KAPITULLI VI

Çështje praktike

Rasti 1: Mënyra e zgjidhjes së problemit kur afati për procesin e shkatërrimit të mallrave të piratuara dhe të falsifikuara (30ditë) i kalon afatet procedurale të sistemit të e-inspektimit (SIMS ka detyrimin të mbajë mallin të bllokuar deri sa gjykata të shprehet me vendimi së formës së prerë).

Trajtimi: Referuar ndryshimeve të fundit të ligjit për pronësinë industriale, në vijim të procesit të inspektimit dhe në përfundim të kryerjes së verifikimeve përkatëse, ISHMT-ja vendos:

a) pranimin e kërkesë-ankesës për inspektim dhe bllokimin përfundimtar të mallrave cenuese, duke informuar përkatësisht mbajtësin/tregtarin e mallrave dhe kërkuesin për procedurat e shkatërrimit të këtyre mallrave;

ose

b) refuzimin e kërkesë-ankesës për inspektim, në rast të mosplotësimit të kushteve formale dhe ligjore përkatëse.

Ligji parashikon në mënyrë eksplicite se, nëse mbajtësi/tregtari i mallrave refuzon dhe kundërshton shkatërrimin e mallrave të bllokuara brenda afatit të përcaktuar në ligj[25], nga momenti kur, ISHMT njofton kërkuesin. Kërkuesi brenda 20 (njëzet) ditëve punë nga data e marrjes së njoftimit të ISHMT-së duhet të fillojë procedimin gjyqësor për shkelje të të drejtave të pronësisë industriale pranë gjykatës kompetente dhe të njoftojë ISHMT-në.

Në vijim ligji ka rregulluara dy situata:

✓ Rastin kur, kërkuesi depoziton kërkesë-padinë për shkelje të të drejtave në gjykatën kompetente dhe paraqet njëkohësisht kopjen e kërkesë-padisë në fjalë pranë ISHMT-së brenda 20 (njëzet) ditëve punë nga data e marrjes së njoftimit për refuzimin/kundërshtimin e shkatërrimit të mallrave nga mbajtësi/tregtari imallrave.

Në këtë rast, ISHMT i mban mallrat të bllokuara deri në momentin e marrjes së një vendimi të formës së prerë nga gjykata për këto mallra.

✓ Rastin kur, kërkuesi nuk depoziton kërkesë-padinë për shkelje të të drejtave në gjykatën kompetente ose nuk paraqet njëkohësisht kopjen e kërkesë-padisë në fjalë pranë ISHMT-së brenda 20 (njëzet) ditëve punë nga data e marrjes së njoftimit për refuzimin/kundërshtimin e shkatërrimit të mallrave nga mbajtësi/tregtari i mallrave.

[25] 5 (pesë)ditë pune.

- *Në këtë situatë, ISHMT bën shënimin përkatës në procesverbalin/inventarin e mbajtur për këtë qëllim dhe revokon automatikisht vendimin për bllokimin e përkohshëm të mallrave në fjalë, duke proceduar me procesin e shkatërrimit të mallit.*
- *Neni 200/b i Ligjit të PI-së :" Bllokimi i mallrave do të kryhet pranë ambienteve të subjektit, duke vendosur nxjerrjen e menjëhershme nga tregu dhe ndalimin e përkohshëm të tregtimit të tyre. ISHMT-ja përpilon e mban procesverbalin/inventarin përkatës për natyrën dhe sasinë e mallit të bllokuar, duke i bashkëlidhur edhe pamjet fotografike që dokumentojnë bllokimin. Inventari dhe pamjet fotografike bëhen pjesë e praktikës përkatëse në sistemin e-inspektimi.*
- **Sqarim:** *Për sa kohë që kryhet nje procedurë e mirëfilltë administrative e dokumentimit të sasisë dhe llojit të mallit në formë dokumentare dhe fotografike, në interpretim logjik të dispozitës rezulton se, ruajtja bëht në vendin e bllokimit, në ambientet e subjektit të tregëtuar. Nëse ka paqartësi për këtë, duhet të sqarohet në aktet nënligjore të ISHMT-së, në varësi edhe të kapaciteteve që disponon ky institucion në funksion të ruajtjes së mallit, duke marrë parasysh që disa mallra mund të kërkojnë kushte të veçanata ruajtje.*

Opinion:

- ✓ Rregullimi i sistemit të dhënies dhe mbrojtjes së të drejtave të pronësisë industriale, si dhe rregullimi i sistemit të mbrojtjes së sekretit tregtar kundrejt përvetësimit, përdorimit dhe bërjes publike në mënyrë të paligjshme është objekt i ligjit të posaçëm nr. 9947, datë 7.7.2008, "Për Pronësinë Industriale", të ndryshuar. Rrjedhimisht, në çdo situatë inspektimi, punonjësit e ISHMT-së, do t'i referohen normave të ligjit të posaçëm dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij. Vetëm në rastet se, një situatë e caktuar nuk gjen rregullim nga normat e posaçme, inspektorët do t'i referohen kuadrit rregullator të përgjithshëm për inspektimin.
- ✓ Gjithashtu, duke pasur në konsideratë parimit "***lex specialis derogat generali***[26]", edhe në rastet kur dispozitat e ligjit nr. 9947/2008, mund të krijojnë mbivendosje apo rezultojnë të mos jenë në harmoni me legjislacionin mbi inspektimin në Republikën e Shqipërisë, ISHMT, nëçdo rast duhet t'i referohet ligjit të posaçëm sa kohë ajo vepron në fushën e kontrollit të mbrojtjes së të drejtave të pronësisë industriale.
- ✓ Respektimi i hierarkisë së akteve normative apo respektimi i parimit "***lex superior derogat inferiori***", është një detyrim që rrjedh nga parimi i shtetit të së drejtës dhe i koherencës në sistemin ligjor. Në rastin e normave me të njëjtën fuqi juridike, edhe Gjykata Kushtetuese thekson se zbatohen parimet, sipas të cilave norma e posaçme ka epërsi ndaj normës së përgjithshme (*lex specialis derogat generali*) dhe se norma që ka hyrë në fuqi më vonë ka përparësi nga norma e mëparshme. Në bazë të parimit të specialitetit, kur dy norma ligjore rregullojnë të njëjtën lëndë, zbatohet norma e posaçme, e cila ka përparësi dhe shmang normën e përgjithshme, kjo në përputhje me kriterin e përgjithshëm juridik për zgjidhjen e kundërshtive "*lex specialis derogat legi generali*".

[26] Kuptimi: "Norma e posaçme ka epërsi ndaj normës së përgjithshme", kur aktet shtrihen në të njëjtin nivel hierarik normash.

Sa referuar më sipër, ISHMT-ja do të zbatojë në çdo rast, parashikimet e neneve 200/b dhe 200/c, të ligjit nr. 9947/2008, të ndryshuar.

Rasti 2: Lidhur me afatin e plotësimit të të metave nga ana e subjektit, ku ligji nr. 10433, date 16.6.2011, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", në nenin 15, pika 4, të tij parashikon një afat 8 (tetë) ditor për të shprehur objeksione, kundërshtime, dokumente shtesë, ndërkohë ligji i posaçëm nr. 9947, datë 7.7.2008, "Për Pronësinë Industriale", i ndryshuar parashikon një afat 5 (pesë) ditor për plotësimin e të metave.

Trajtimi: Ligji nr. 10433/2011, në nenin 15, pika 4, parashikon të drejtë e subjektit të inspektimit që, përpara marrjes së vendimit përfundimtar të paraqesë me shkrim apo me gojë shpjegimet apo kontestimet e tij për faktet dhe rrethanat e konstatuara në procesverbal. Ndërkohë që, ligji nr. 9947/2008, në nenin 200/b, pika 7, parashikon të drejtën e ISHMT-së, për të kërkuar shpjegime dhe dokumente mbështetëse për origjinën e mallrave nga mbajtësi/tregtari i mallrave që dyshohet se shkelin një të drejtë të pronësisë industriale në mënyrë që ky i fundit të provojë dhe të vërtetojë se mallrat janë origjinale. Në këtë rast, ligji ka parashikuar se, shpjegimet dhe dokumentet mbështetëse të kërkuara vendosen në dispozicion të ISHMT-së brenda 5 (pesë) ditëve punë nga data e njoftimit.

Për të bërë një qartësim të normave ligjore, na vjen në ndihmë interpretimi. Në këtë rast, nëinterpretim literal, sistematik dhe teleologjik (sipas qëllimit të vetë dispozitës) të 2 (dy) dispozitave, të sipër cituara, konstatohet se:

- Këto dy dispozita, nuk trajtojnë të njëjtat raste;
- Ligjvënësi në këtë rast i ka dhënë mundësinë subjekteve të inspektuara që të paraqesin dokumentacion shtesë/shpjegime, dhe gjithashtu, përpara vendimmarrjes të shprehin objeksionet, qëndrimet, kundërshtimet e tyre, shoqëruar edhe me prova shtesë (nëse disponojnë).

Opinion

Ndodhur në kushtet kur, nuk ndodhemi përpara përplasjes së dy dispozitave të ligjeve, të cilat qëndrojnë në të njëjtën hierarki normash, në rastin e inspektimeve, inspektorët do të veprojnë sipas dy parashikimeve ligjore, përkatësisht:

- ✓ Në rastin kur, ISHMT kërkon shpjegime dhe dokumente mbështetëse për origjinën e mallrave nga mbajtësi/tregtari i mallrave që dyshohet se shkelin një të drejtë të pronësisë industriale në mënyrë që ky i fundit të provojë dhe të vërtetojë se mallrat janë origjinale. Në këtë rast, shpjegimet dhe dokumentet mbështetëse të kërkuara vendosen në dispozicion të ISHMT-së **brenda 5 (pesë) ditëve punë nga data e njoftimit**[27].
- ✓ Ndërkohë, në çdo rast, procesverbali i inspektimit duhet të parashikojë informacion për

[27] Neni 200/b, pika 7, e ligjit nr. 9947/2008

të drejtën e subjektit të inspektimit që të paraqesë me shkrim apo me gojë shpjegimet apo kontestimet e tij për faktet dhe rrethanat e konstatuara në procesverbal. Në këtë rast, subjekti i inspektimit duhet t'i paraqesë brenda një afati të përcaktuar nga inspektori, **por jo më të shkurtër se 8 ditë**[28] nga data e njoftimit të procesverbalit, për paraqitjen e këtyre komenteve, si dhe organin ku paraqiten këto komente. Kalimi i afatit minimalisht 8 (tetë) ditor, në rastin kur subjekti nuk paraqet kundërshtime/shpjegime, apo kontestime,është kusht *si ne qua non*[29], pa kalimin e të cilit nuk mund të disponohet me vendim përfundimtar, përveç rastit kur, vendimi merret menjëherë/në procesverbal, dhe nuk ka relevancë asnjë objeksion/kundërshtim, pasi faktet janë konkrete dhe të dukshme.

Sa referuar më sipër, ISHMT-ja do të zbatojë në çdo rast, parashikimet e neneve të cituara më lart, dhe neni 15, pika 4, i ligjit nr. 10433/2011, gjen zbatim të çdo rast inspektimi.

[28] Neni 15, pika 4, ligji nr. 10433/2011.
[29] Kuptimi: "… pa të cilin nuk mund të …/kusht esencial"

Paraqitja grafike e procesit të inspektimit

